



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Mësuesi në  
Shkenca Sociale”  
ofruar nga  
Universiteti “Barleti”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Blerina Hamzallari**

**Prof. Asoc. Dr. Nada Kallçiu**

**Nëntor/ 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Mater Profesional në "Mësuesi në Shkenca Sociale"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Mësuesi në Shkenca Sociale"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS nr. 588, datë 04.10.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/ 0 PAK v.a.2022-2023 5 PAE/ 1 PAK v.a.2023-2024
18	Numri i studentëve:	2022-2023 - 3 studentë 2024-2025 - 5 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit “Master Profesional” në “Mësuesi i Shkencave Sociale” është hapur me Urdhër Ministri Nr. 1760/2, datë 04.10.2022 dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit profesional, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Univeristetin “Barleti”.

Njësia bazë e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional funksion në strukturën organizative të fakultetit të shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, të krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 571, datë 12.08.2005. Programi i ofruar është i organizuar sipas nivelit 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, forma e studimeve është me kohë të plotë me një kohëzgjatje të studimeve në 2 (dy) vite akademike, përgjatë të cilave studenti fiton 120 ECTS. Programi i studimit është organizuar në dy vite me nga 60 kredite në secilin vit, përkatësisht 1500 orë mësimore të organizuara në modalitetet e veprimtarive të pavarura dhe veprimtarive në auditor.

Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe dhe është i organizuar në lëndë dhe module lëndore sipas tipeve të veprimtarive formuese të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Europian të transferimit dhe të grumbullimit të krediteve (ECTS). Në përfundim të programit të studimeve studentët pajisen me diplomën “Master Profesional” në “Mësuesi i Shkencave Sociale” dhe me suplementin përkatës në gjuhën Shqipe dhe Angleze në përputhje me elementët e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 11. datë 2.4.2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës.

Kurrikula e programit të studimit është hartuar dhe organizuar në përputhje me zhvillimet e fushës dhe në përgjigje të interesave dhe nevojave kombëtare. Gjatë zhvillimit të programit të studimit ofrohet literaturë e pasur në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, duke mundësuar ndërthurjen e përvojave studimore vendase dhe ndërkombëtare të fushës së studimit në mësuesi dhe në shkencë sociale. Programi i studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkencë Sociale” është hartuar dhe ofrohet në zbatim dhe në përputhje me strategjinë për zhvillim institucional të Univeristetit “Barleti”, në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional si dhe në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit të Universitetit “Barleti”.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Kreu X: Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, mbështetur në VKM nr. 109 për organizimin e ASCAL dhe në Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017, për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale” ofruar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit të Universitetit “Barleti” ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit Prof. Asoc. Dr. Nada Kallçiu dhe Prof. Asoc. Dr. Blerina Hamzallari. Gjatë procesin të vlerësimit të jashtëm grupi i ekspertëve është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Rajna Lila.

Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale” gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në data 19-20 mars 2024. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht Univeristetit “Barleti” sipas parashikimeve të akteve rregullatorë të ASCAL.

GVJ ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme RVB-në dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përpara vizitave të institucion në mënyrë që të zhvillonte një takim të mirëinformuar paraprakisht me aktorët e programit të studimit. Gjatë vizitës dy ditore (19-20 mars 2024) në Univeristetin “Barleti” u mbajtën takime me drejtuesin e njësisë kryesore dhe drejtuesin e njësisë bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, me përfaqësues të zyrës së kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së këshillimit të karrierës dhe Alumni, me përfaqësues të strukturave institucionale të sigurimit të standarteve dhe të cilësisë në IAL, me përfaqësues të strukturave të kooordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, me përfaqësues të drejtorisë së burimeve njerëzore, gjithashtu u zhvilluan vizita në mjedise të FSHSTS dhe UniBA si në biblioteka, mjedise studimi, auditore, laboratorë, në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Mësuesi në Shkencave Sociale”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi I.1**

**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Barleti” është institucion jopublik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili në misionin dhe vizionin e tij ka të përcaktuar qartë orientimin e veprimtarisë së tij për formimin e profesionistëve novatorë, krijues i sipërmarrës, të aftë për sfidat e së tashmës dhe të ardhmes. Veprimtaria e UniBA përputhet me prioritetet e zhvillimit kombëtar duke kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare në një mjedis social në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. <i>(1.1. Statuti i UniBA, neni 4: Misioni dhe neni 5: Vizioni)</i> Edhe në programin e studimit Master profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” institucioni dëshmon nëpërmjet programeve lëndore kontekstualizimin e situatave mësimore në funksion të evidentimit dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare në një kontekst gjithnjë e më të difuzuar në kontakte ndërkulturore. <i>(dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet lëndore).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” (MP MSHS) është hapur me Urdhër Ministri Nr. 1760/2, datë 04.10.2022 dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional (DSHETP), Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në UniBA. <i>(Urdhër për hapjen e programit të studimit)</i> Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së Njesisë bazë dhe Njesisë kryesore. Në dokumentat themelore të programit të studimit MP. MSHS dëshmohej se programi është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me qëllimin dhe misionin e UniBA. <i>(1.1. Statuti i UniBA; 5. Strategjia e zhvillimit të Departamentit: I. Vizioni dhe II. Misioni; dokumentacioni shtesë në e-asca Rregullore e programit të studimit, neni 2 dhe neni 3)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim	Programi i studimit të ciklit të dytë MP. MSHS është hartuar dhe ofrohet në zbatim dhe në përshtatje me strategjinë për zhvillim institucional të UniBA, të rregullores së organizimit dhe të

<p>të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>funksionimit të UniBA dhe në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të DSHETP në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, të Universitetit “Barleti”.</p> <p>Përmbushja e këtij kriteri në ofrimin e programit MP. MSHS duket qartë në përputhjen e e vizionit, qëllimit dhe objektivave të ofrimit të programit të studimit, të cilat ndërtohen në frymën e zhvillimit të strategjisë institucionale dhe në përputhje me aktet e brëndshme rregullative të UniBA.</p> <p><i>(1.1. Statuti i UniBA; 10. Strategjia e Zhvillimit institucional 2020-2030; 1.2 Rregullore e UniBA; 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; dokumentacioni shtesë në e-ascal Rregullore e programit të studimit).</i></p> <p>Strategjia e zhvillimit të Departamentit, e cila shpreh dhe strategjinë e hartimit dhe konsolidimit të programeve të mësuesisë është ndërtuar gjithashtu, bazuar në shtyllat e strategjisë së Institucionit. Me shtylla bazë zhvillimi strategjik ofrimin e kurrikulave bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesën e tregut të punës, ndërkombëtarizimin, zhvillimin e partneriteteve, studentët.</p> <p><i>(5. Strategjia e zhvillimit të Departamentit; 10. Strategjia e Zhvillimit institucional 2020-2030)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të depozituar në e-ascal, programi i studimit MP MSHS është hapur për herë të parë në UniBA duke nisur veprimtarinë e tij në vitin akademik 2022-2023. Nga sa reflektohet në dokumentacionin e programeve lëndore dhe organizimit kurrikular, programi i studimit zhvillohet në linjë me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. Në linjë vertikale të dokumentacionit theksohet qëllimi i UniBa për të ofruar studime universitare në përputhje me European Qualification Framework dhe Kornizën Shqiptare të Profesioneve, të bazuara në kërkimin e inovacionit si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplikimit, për të përgatitur teknikë, specialistë dhe ekspertë të mirë-formuar.</p> <p>UniBa ka për qëllim të zhvillojë programe formuese dhe trajnuese si dhe të realizojë shërbime arsimore, sociale dhe kulturore në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare. Në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, ai ka për qëllim të ofrojë programe studimi afatshkurtra për kualifikime e specializime, si dhe për përditësimin e dijeve të fituara. Programi i Studimit MP MSHS</p>



	<p>është hartuar si program studimi i ciklit të dytë “Master Profesional”, me 120 ECTS dhe në dy vite akademike, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p><i>(dokumentacioni shtesë në e-ascal Rregullore e programit të studimit, 1.2 Rregullore e UniBA; 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, dokumentacioni shtesë në e-ascal Rregullore e Departamentit, 5. Strategjia e zhvillimit të Departamentit; 10. Strategjia e Zhvillimit institucional 2020-2030)</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Referuar dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë rezulton se Universiteti Barleti ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Në politikat e zhvillimit të programeve të studimit synohet zhvillimi i interesave dhe vlerave kombëtare si dhe ruajtja e tyre edhe në kontekstin e ndërkombëtarizimit dhe botës sociale në ndryshim të vazhdueshëm. Programi i studimit “Master profesional” në “Mësues në Shkenca Sociale”, ofruar nga Departamenti i Shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit të Universitetit Barleti është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të Institucionit të Arsimit të Lartë.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti “Barleti” është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 571, dt.12.08.2005 si pjesë e grupit “DUDAJ” nga “Barleti sh.p.k”. Institucioni ndryshoi emrin në “Univeristetit “barleti” në vitin 2020 me Urdhër të MASR Nr. 213, datë 3.7.2020. Institucioni është akredituar për herë të dytë nga Agjencia e Sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë me 5 vite, nëpërmjet vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 60, datë 16.12.2021. Jetëgjatësia e Institucionit të arsimit të lartë dhe vetëreformimi i tij dëshmojnë qëndrueshmërinë dhe përvojë në sfondin e Arsimit të Lartë në republikën e Shqipërisë.</p>

*(1.4.a. Vendim Nr. 571 dt 12.08.2005 - Dhenie leje per hapje te institucionit; .4.b. Urdher MASR nr. 511 dt. 24.10.2019 - Per Riorganizimin Institucional; 1.4.c. Akreditimi institucional UniBa; Evidenca 1.4.d. Urdher nr 213 date 3.7.2020 Riorganizimi per ndryshimin e statusit. 10. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, Kreu II, 1.1. Statuti i Universitetit Barleti, kreu I, Neni 1.)*

Njësia bazë e Departamentit Shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional është pjesë e strukturës organizative të Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në UniBA. Profili i studimeve në Master Profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” (MP. MSHS.) është hapur me Urdhër Ministri Nr. 1760/2, datë 04.10.2022 dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional (DSHETP), Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS) në UniBA.  
*(Urdhër për hapjen e programit të studimit)*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, FSHSTS deklarohet se për vitin akademik 2022-2023 ka patur të angazhuar gjithsej 70 pedagogë, prej të cilëve 36 me statusin e personelit akademik me kohë të plotë prej të cilëve: 1 të kategorisë Prof. Dr.; 4 të kategorisë Prof. Asoc.; 12 të kategorisë Dr.; 19 të kategorisë MSc. Nga personeli akademik i FSHSTS në vitin akademik 2022-2023, 34 pedagogë janë të angazhuar me kontratë me kohë të pjesshme, prej të cilëve: 1 të kategorisë Prof. Dr.; 3 të kategorisë Prof. Asoc.; 12 të kategorisë Dr.; 18 të kategorisë MSc. Në vitin 2023-2024, FSHSTS ka angazhuar 68 pedagogë, 38 prej të cilëve personel akademik efektiv dhe 30 personel akademik me kontratë. Nga PAE i angazhuar janë: 1 të kategorisë Prof. Dr.; 5 të kategorisë Prof. Asoc.; 13 të kategorisë Dr.; 19 të kategorisë MSc. Nga PAK angazhuar në vitin akademik 2023-2024, janë: 1 të kategorisë Prof. Dr.; 4 të kategorisë Prof. Asoc.; 23 të kategorisë Dr.; 2 të kategorisë Dr. në proc.; 11 të kategorisë MSc.

Ndërsa **Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe trajnimit profesional**, si departamenti përgjegës i ofrimit të programit të studimit MP. MSHS deklarohet të ketë patur për vitin akademik 2022-2023, 7 personel akademik të angazhuar me kohë të plotë (PAE) dhe 0 personel akademik me kontratë (PAK). Nga PAE në DSHETP rezulton se: 2 pedagogë kanë qënë të kategorisë Prof. Asoc.; 4 pedagogë janë të kategorisë Dr dhe 1 pedagog i kategorisë Msc.





	<p><b>DSHETP</b> për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar 5 PAE (2 të kategorisë Prof. Asoc. Dr. dhe 3 personel akademik të kategorisë Dr.) dhe 1 PAK të kategorisë Dr. (<i>Aneksat e RVB-tabela 1, Tabela 2</i>).</p> <p>Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë programi të studimit MP. MSHS e përmbush kriterin e standarteve të cilësisë në arsimin e lartë për të mbuluar të paktën 70% të ngarkesës mësimore në programin e studimit me personel akademik me kohë të plotë.</p> <p>(<i>Aneksat e RVB-tabelat 12<sup>1</sup>-12<sup>2</sup>, 7.2. CV e stafit akademik</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit MP. MSHS dhe programeve lëndore rezultoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, FSHSTS, që është njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Përputhshmëria e fushës së studimit në programin MP. MSHS me njësinë kryesore është konform direktivave dhe udhëzimeve kombëtare, të cilat iu përmbahen direktivave evropiane të klasifikimit dhe kodifikimit.</p> <p>(<i>Aneksat e RVB-tabela 10, dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 10. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit, Rregullore e programit të studimit- dokumentacion shtesë në e-ascal, Rregullore e Departamentit- dokumentacion shtesë në e-ascal</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në Strategjinë e zhvillimit të DSHETP, deklarohet qartë se puna e DSHETP është e fokusuar në konsolidim të programeve të studimit në Master në Mësuesi, në 7 profile që mbulojnë të tre ciklet e arsimit parauniversitar. Në këtë kuadër DSHETP mund të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë sipas nenit 14 të Rregullores së departamentit, ku organizimi, struktura dhe përmbajtja e këtyre programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimet akadémike të DSHETP, si edhe në përputhje të plotë me klasifikimin/ kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës, si edhe direktivave evropiane në ato raste kur këto direktiva janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë". Programi i studimit në tërësinë e gjithë</p>

	<p>elementëve të tij organizativë dhe përmbajtësorë përputhet me fushën akademike e kërkimore të Departamentit si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në UniBa.</p> <p><i>(Rregullore e Departamentit- dokumentacion shtesë në e-ascal, 5. Strategjia e zhvillimit te Departamentit, Aneksat e RVB-tabela 3)</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky program studimi Master Profesional, ofrohet në përphtje me profilin e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit dhe njësisë bazë të DSHETP në UniBa.</p> <p><i>(1. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Sociale dhe Turizmit, Rregullore e programit të studimit- dokumentacion shtesë në e-ascal, Rregullore e Departamentit- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>DSHETP sipas strategjisë së zhvillimit të tij 2022-2025 ka në fokus të tij ofrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë, zbatimin me cilësi të programit të shkollës së drejtorëve, zhvillimin e trajnimeve online për personelin arsimor në shërbim si dhe pasurimin e ofertës dhe zhvillimit të trajnimeve për zhvillimin profesional dhe ofrimin e kualifikimeve të vazhduara. Sikurse edhe u pohua gjatë takimeve në ditët e vizitave në institucion për studentë dhe ish studentë UniBA ofron trajnime profesionale të vazhdueshme profesionale. në kuadër të programeve të trajnimeve për studentët e tij.</p> <p><i>(5. Strategjia e zhvillimit te Departamentit, 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe ëorkshopeve, 13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar, informacion nga vizita në institucion, 19.03.2024)</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në gjetjet dhe evidencat e kriterëve të standartit I.2, rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” është në përputhje me fushën akademike të akultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit dhe të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ofruar në Universitetin “Barleti”</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi akademik dhe administrativ i UniBA dëshmon rëndësinë e marrëdhënieve bashkëpunuese dhe kolegjalitetit në nivele të ndryshme të organizimit brenda institucionit për mbarëvajtjen e programit të studimit MP. MSHS. Fryma e bashkëpunimit shprehet nëpërmjet ndarjes së detyrave të personelit akademik dhe administrativ në funksion të mbështetjes së punës së programit të studimit.</p> <p><i>(1.1. Statuti UniBA, Kreu II, 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit, Rregullore e programit të studimit- dokumentacion shtesë në e-ascal, Rregullore e Departamentit- dokumentacion shtesë në e-ascal).</i></p> <p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit dhe marrja e përgjegjësisë përkatëse planifikohet që në fillim të vitit akademik, duke siguruar realizimin me sukses të veprimtarive të parapara në planin mësimor dhe programet lëndore për programin e studimit.</p> <p><i>(Anekset e RVB-tabelat 12<sup>1</sup>-12<sup>2</sup>, Anekset e RVB-tabela 4, Anekset e RVB-tabelat 6)</i></p> <p>Në funksion të mbikëqyrjes dhe mbarëvajtjes së programit të studimit të gjithë aktorët e përfshirë raportojnë mbi punën e tyre dhe në praktikën e punës së njësive bazë të ofrimit të programit të studimit analiza e punës shprehet në disa formate raportimi për kërkimin shkencor, për procesin mësimor, për aftësitë e personelit akademik në mësimdhënie, për zhvillimin e programeve lëndore. Të dhënat e plota të analizës së punës së DSHETP përfshihen në Raportet e punës semestrale, në raportet vjetore të cilësisë, në raportet vjetore me punën kërkimore dhe në raportet mbi vlerësimin e studentëve.</p> <p><i>(16.3. Format i Raportimit të Punës Semestrale, 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit _Sem I, 21. Raport vjetor i punës kërkimore 2021-2022 dhe 2022 – 2023, 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit</p>	<p>Në dokumentin e strategjisë së zhvillimit të Institucionit 2020-2030, UniBA ka për vizion “të bëhet një institucion inovativ dhe</p>

<p>mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>lider, digjital, aplikativ dhe praktik, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës, duke vendosur studentin në qendër dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale e ndërkombëtare”. Në funksion të vizionit të tij institucioni ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit me objektiva kryesorë: 1. Eksperiencën globale të studentëve, 2. Partneritete globale, 3. Tërheqjen e studentëve të huaj, 4. Ofrimin e mundësive në rang global. Marrëveshjet në kuadër të proceseve ndërkombëtarizuese (rreth 32 marrëveshje) gjithashtu janë të pasura, ndër të cilat mund të përmendim:  West University of Timisoara, Romania.  Janos University of applied sciences, Hungary.  West attica University, Greece.  Technical University of Liberec, Czech Republic, etj.</p> <p><i>(10. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, III.1.2.; Evidenca 10.1. Strategjia e ndërkombëtarizimit, pika 5., 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale për të cilat DSHETP vendos në dispozicion një listë me rreth 30 institucione të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.</p> <p><i>(22. Liste e marreveshjeve te Departamentit, Aneksat e RVB-tabela 5)</i></p> <p>UniBA, FSHSTS dhe DSHETP dëshmojnë se në veprimtaritë e tyre kërkimore shkencore bashkëpunojnë me institucione dhe kompani të fushave të ndryshme. Disa veprimtari kërkimore të realizuara në bashkëpunim janë:  Konferenca e 6-të ndërkombëtare “Future Smart Cities (FSC) 7.8.2023.  Konferenca ndërkombëtare mbi “Rigjenerimin dhe qëndrueshmërinë urbane” 22.12.2022  <i>(32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve; 9. Evidence e kerkimit shkencor, 21. Raport vjetor i punes kerkimore 2021-2022 dhe 2022 - 2023.pdf)</i></p> <p>UniBA dhe DSHETP dëshmojnë se si programin kryesor me anë të të cilit mundësohet mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik është ERASMUS+.</p> <p><b><i>Nga evidencat në dispozicion rezulton se personeli akademik i programit të studimit ka përfituar nga bursat e programit të</i></b></p>

	<b>mobilitetit Erasmus+, por jo studentët e programit të studimit MP. MSHS.</b> (32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +, 13.b. Shkëmbimet Erasmus+.pdf)			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, ku ofrohet programi i studimit Master Profesional në "Mësuesi në Shkenca Sociale" harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto të dhëna pasqyrohen në dokumenta si raporti i punës semestrale dhe raportet vjetore të punës.  (16.3. Format i Raportimit të Punës Semestrale, 21. Raport vjetor i punes kerkimore 2021-2022 dhe 2022 - 2023.)			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton se Universiteti "Barleti" ka politika strategjike të qëndrueshme të rritjes dhe zhvillimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. + <b>GVJ sugjeron që Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit, pasi nuk ka asnjë student përfitues nga programe shkëmbimi nga programi i studimit nën akreditim.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

### Standardi II.1

**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu VII, neni 71 pika 2 dhe 3 shprehet si më poshtë:</p> <p>“Pika 2; Elementet që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”</p> <p>“Pika 3; Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statut dhe rregullore elemente të hollësishme për programet e studimeve që ato ofrojnë.”</p> <p>Në nenin 83 të Ligjit 80/2015 për programet e studimit në fushën e mësuesisë, pika 2, 3 dhe 4 përcaktohet se: “Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit. / Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. / Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.”</p> <p>Sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, duhet të jenë sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” (e ndryshuar), Pika 2, shprehet se: Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</li> <li>kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>planin mësimor;</li> <li>kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</li> <li>programin lëndor (Syllabus-et);</li> <li>profilin e programit;</li> <li>diplomën dhe suplementin;</li> </ul>

Programi i studimeve të ciklit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale” i përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit sipas përcaktimeve të VKM 41 dhe kjo dëshmohet nëpërmjet evidencave të përcjella me dosjen e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.

*(Anekset e RVB-tabela 10, tabela 9, tabela 13, tabela 15; dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit; 5. Rregullore e programit të studimit.- dokumentacion shtesë në e-ascal, 2.1.b. Plani mësimor\_Mesuesi në Shkenca Sociale, 15. Template i Diplomes MP në MNX.- dokumentacioni shtesë në e-ascal, 16. Suplementi i Diplomes MP në MNX.- dokumentacioni shtesë në e-ascal)*

GVJ konstaton se institucioni nuk ka përmbushur sugjerimin e ekspertëve të shprehur në Urdhrin e hapjes së programit të studimit mbi rishikimin e titullit dhe për rrjedhojë përmbajtjes së lëndës “Metodat e avancuara të kërkimit”, e cila në planin mësimor të programit të studimit duhet të ishte ndryshuar në “Metodat e kërkimit në edukim”. **Pas rishikimit të përmbajtjes lëndore të kësaj lënde GVJ konstaton se:**

në programin e lëndës kjo lëndë është e përcaktuar si karakterizuese dhe jo si lëndë bazë përmbledhja dhe rezultatet e të nxënësve nuk përkojnë me qëllimin dhe objektivat e lëndës.

Kërkimi në shkencë sociale (që është dhe teksti bazë), është dukshëm më i gjerë se metodat e kërkimit në edukim.

***GVJ-Sugjeron që lënda “Metodat e kërkimit të avancuara” të ndryshohet në “Metodat e kërkimit në edukim” dhe tekstet e përdorura për lëndën të përkojnë me Metodatat e kërkimit në edukim.***

***GVJ-ja konstaton se programi i studimit në vlerësim ka disa papërputhshmëri me VKM 41(të ndryshuar), në peshën që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit në planin mësimor.***

Nga analizimi i të dhënave të programit të studimit rezulton si më poshtë vijon:

Kateg.	Komponenti	Vkm.	Plani mësimor	Kreditet Plani
		41		

		për MP		mesimor
A	Lëndë bazë	5-10%	9.2%	11
B	Lëndë karakterizuese	30-40%	40.8%	49
C	Lëndë ndërdisip/ Integruese	20-30%	35%	42
D	Lëndë plotësuese	10%	5%	6
E	Detyrime përmyllëse	10-20%	14.4%	12

*(Anekset e RVB-tabela 10, tabela 9, dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 2.1.b. Plani mësimor\_Mesuesi ne Shkenca Sociale).*

**Nga sa më sipër, Gvj-ja konstaton se ashtu sikurse edhe përcaktimet e VKM 41 (të ndryshuar) sanksionojnë:**

- Praktika profesionale është komponent mësimor i kategorisë D (lëndë plotësuese), dhe ajo nuk mund të përcaktohet, sikurse vihet re edhe në plan, si veprimtari e kategorisë C (Lëndë ndërdisiplinare/integruese).**
- Ka papërputhshmëri në përcaktimin e kategorisë së komponentit mësimor edhe tek lënda aftësim praktik në Sociologji, Filozofi dhe Psikologji.**


*(Anekset e RVB-tabela 10, tabela 9, 2.1.b. Plani mësimor\_Mesuesi ne Shkenca Sociale)*

**Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme

Sipas objektivave të programit të studimit MP MSHS ndër të tjera synohet të aftësohen studentët për të planifikuar dhe zhvilluar në mënyrë efektive kurrikulën për lëndët e shkencave sociale (Sociologji, Filozofi, Psikologji). Programi synon të përgatisë mësues profesionistë, në fushë të shkencave sociale.

***GVJ-ja konstaton që plani mësimor i programit të studimit ka përcaktime të përgjithshme lëndore (Kurrikula e shkencave Sociale), përmbajtjen e të cilave duhet t'a njohë përmes syllabuseve lëndore. Edhe pse gjatë vizitës në institucion (19.03.2024) u kërkuan programet lëndore sërish ato janë depozituar në mënyrë të pjeshme ose jo korresponduese me programin e studimit në vlerësim në sistemin e-ascal. Në këto kushtë Gvj-ja e ka të pamundur të vlerësojë nivelin e njohurive të lidhura me fushën e studimit dhe të punësimit si "Mësues në***

<p>për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><b>Shkenca sociale”.</b></p> <p><i>(2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale, dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 5. Rregullore e programit te studimit.- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit rezulton se në programin e studimit MP. MSHS ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës dhe aftësisimit praktik në shkenca sociale 24 kredite. (në mungesë përputhshmërie me përqindjet, kategoritë dhe komponentët mësimorë të përcaktuar në VKM 41, shih standartin II.1. kriteri 1.)</p> <p>Gjithashtu në planin mësimor të programit të studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për detyrimet përmbyllëse të përcaktuara sipas VKM 41. (12 ETC).</p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 9, tabela 10; 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale,)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nga plani mësimor i programit të studimit rezulton se programi i studimit MP. MSHS. është një program “Master” në Mësuesi për formimin e mësuesve në fushat e formimit Psikologji, Sociologji, Filozofi duke konsoliduar formimin në kurrikulën e filozofisë, Sociologjisë dhe Psikologjisë.</p> <p><i>(2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale, dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë</p>	<p>Programi i studimit MP. MSHS. organizohet si program “Master” me 120 ESTS. Në kurrikulën e programit të studimit vihen re lëndë të formimit Psiko-pedagogjik (Psikologji edukimi, Zhvillim kurrikule dhe mendim kritik, Teoritë e të nxënës dhe modelet e mësimdhënies, Menaxhimi i klasës, Vlerësimi për të nxënësit dhe i të nxënës, Edukimi dhe bashkëpunimi me prindërit, etj.), të cilat e tejkalojnë 25% të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.</p> <p>Gjatë vizitave në Institucion (19.03.2024) u nënvizua referimi ndaj</p>

<p>mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>kurrikulave të ngjashme për ndërtimin e kurrikulës së programit të studimit, duke synuar mbërritjen e 80% ngjashmëri me programet e ngjashme në të njëjtën fushë.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion, 19.03.2024, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë Kreu III, Seksioni I, Neni 17: Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë, pika 5 përcaktohet se:</p> <p>“Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, gëzojnë status të veçantë. Ky status i jepet institucionit të arsimit të lartë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.”</p> <p>Sipas këtij përcaktimi, Universiteti “Barleti” nuk është Institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga vizitat në Institucion në datat 19-20 mars 2024, GVB deklaroi se program i studimit MP MSHS ofrohet në ngjashmëri të paktën në 70% të kurrikulës së programit të studimit me programe të tjera që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Edhe nga verifikimet e Gvj rezulton se program i studimit të ciklit të dytë MP MSHS ka përmbajtje të ngjashme në të paktën 70% me programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion, 19-20.03.2024, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale, 5. Rregullore e programit te studimit.- dokumentacion shtesë në e-ascal )</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022 për “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, pika 12 theksohet se:</p> <p>“Për programet e studimit ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre brenda muajit Mars 2023”. Deri në daljen e akteve të reja nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse Kodi i programit të studimit përcaktohet vetëm sipas Vendimit 310, datë 11.05.2022 pika 2d, sipas së cilës programet e studimit “Master Profesional” me 120 ECTS identifikohen</p>



	nëprmet kodit 72MP.
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i Studimit MP MSHS nuk është një program i përbashkët studimi.
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se në përgjithësi programi i studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale” organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë në përputhje me VKM 41, veprimtaritë formuese janë të organizuara sipas kategorive të VKM 41 dhe të të vlerësuara në kredite, sipas Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>GVJ vëren se:</i></p> <p><i>Institucioni nuk ka përmbushur sugjerimin e ekspertëve të shprehur në Urdhrin e hapjes së programit të studimit mbi rishikimin e titullit dhe për rrjedhojë përmbajtjes së lëndës “Metodat e avancuara të kërkimit”, e cila në planin mësimor të programit të studimit duhet të ishte ndryshuar në “Metodat e kërkimit në edukim”. GVJ-Sugjeron që lënda “Metodat e kërkimit të avancuara” të ndryshohet në “Metodat e kërkimit në edukim” dhe tekstet e përdorura për lëndën të përkojnë me Metodatat e kërkimit në edukim.</i></p> <p><i>GVJ-ja konstaton se programi i studimit në vlerësim ka disa papërputhshmëri me VKM 41 (të ndryshuar), në peshën që zë secila kategori e komponentëve mësimorë në planin mësimor të programit të studimit. GVJ-Sugjeron rishikimin e kategorive të komponentëve mësimorë sipas përcaktimeve në VKM 41, të ndryshuar.</i></p> <p><i>Gvj-ja vëren se kreditet në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik tejkalojnë përcaktimin e peshës specifike prej 25% të krediteve, duke limituar kreditet dhe orët në dispozicion të fushave specifike të programit të studimit “Mësuesi në Shkëncë Sociale. GVJ-Sugjeron rishikimin e peshës specifike të lëndëve të</i></p>

	<i>formimit psiko-pedagogjik në funksion të kurrikulave të lëndëve karakterizuese në fushë të shkencave sociale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</b>	<p>Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë përcaktohen qartë detyrimet e njësisë kryesore dhe njësisë bazë në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike si më poshtë vijon:</p> <p>Në Nenin 23 të Ligjit përcaktohet se: “Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. ...Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë”.</p> <p>Në Nenin 25 të ligjit përcaktohet se Departamenti: “Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. ...Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.”</p> <p>Bazuar në përcaktimet e mësipërme GVJ konstaton se njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit MP MSHS, <b>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit</b> përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe përmban në strukturën e tij <b>4 njësi bazë (Departamente):</b> Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve</p>

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional  
 Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit  
 Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit  
 Në vitin 2023-2024, FSHSTS ka angazhuar 68 pedagogë, 38 prej të cilëve personel akademik efektiv dhe 30 personel akademik me kontratë. Nga PAE i angazhuar janë: 1 të kategorisë Prof. Dr.; 5 të kategorisë Prof. Asoc.; 13 të kategorisë Dr.; 19 të kategorisë MSc. Nga PAK angazhuar në vitin akademik 2023-2024, janë: 1 të kategorisë Prof. Dr.; 4 të kategorisë Prof. Asoc.; 23 të kategorisë Dr.; 2 të kategorisë Dr. në proc.; 11 të kategorisë MSc. Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit, **Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional DSHETP** për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar 8 PAE (2 të kategorisë Prof. Asoc. Dr. dhe 4 personel akademik të kategorisë Dr. Dhe 2 kategorisë Msc) dhe 4 PAK 3 të kategorisë Dr dhe 1 kategorisë Prof.Asoc.

Kualifikimi i stafit akademik për DAP	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	-	-
Prof. Asoc.	-	1	2	1
Dr./PhD.	4	1	4	3
MSc.	2	-	2	-
<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>4</b>

(1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit.pdf, Neni 2, Anekset e RVB-tabela 1, tabela 2).

DSHETP është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të FSHSTS -së dhe ofron programe studimi në fusha kërkimi të përafërta. DSHETP është përgjegjës për 5 programe studimi të ciklit të dytë "Master Profesional" veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore e të cilëve është në administritim të tij.

(Anekset e RVB-tabela 3).

Njësia kryesore dhe njësia bazë e ofrimit të programit të studimit MP. MSHS në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Kreu X: Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, Neni 106: Akreditimi; ju nënshtrohen proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të vlerësimit të jashtëm

	<p>në mënyrë periodike dhe e dokumentojnë këtë proces në forma të ndryshme të raporteve.</p> <p><i>(48.1. Raport vjetor per vleresimin e cilesise ne UniBa.pdf, 21. Raport vjetor i punes kerkimore 2021-2022 dhe 2022 – 2023, 16.3. Format i Raportimit të Punës Semestrare, 1.4.c. Akreditimi institucional UniBa.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi i studimit MP. MSHS ofruar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në planin e tij mësimor ka të paraprirë zhvillimin e praktikës institucionale. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel akademik efektiv për realizimin e praktikave institucionale. Praktikrat profesionale janë të rregulluara gjithashtu nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione me fushë veprimi në dobi të programit të studimit dhe modalitetet e vlerësimit gjatë praktikës janë përcaktuar në paketën e praktikës.</p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 5, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale, 2.3. UniBa Paketa e praktikës, 22. Liste e marreveshjeve te Departamentit, Anekset e RVB-tabela 10, 5. Rregullore e programit te studimit, neni 12- dokumentacioni shtesë në e-ascal)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sipas akteve të brendshme rregullative të UniBA, koordinorët e programeve të studimit caktohen nga Rektori. Roli qëndror i koordinorit të programit të studimit është të sigurojë dhe të kooordinojë ndërveprimin për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e UniBa, neni 18, 1.1. Statuti i Universitetit Barleti, neni 30., Urdhër 29, 14.10.2022 Për përcaktimin e koordinorit të programit të studimit)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Sociale, turizmit dhe Sportit si njësi kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale” përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, caktimin e një koordinor për programin e studimit në funksion të realizimit të objektivave të tij dhe të drejtimit të praktikave profesionale nga personel akademik. Njësia</i></p>

	<i>kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit</b></p>	<p>Në rregulloren e njësisë kryesore të FSHSTS, neni 11 dhe neni 12 përcaktohen fushat e studimit dhe programet e studimit që ofrohen në këtë njësi kryesore. Në këtë rregullore vihen në dispozicion informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit që ofrohen në FSHSTS. Rregullorja e programit të studimit është përcaktuar si një nga dokumentet bazë të programit të studimit në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Rregullorja e programit të Studimit MP. MSHS rezulton të jetë miratuar në vitin 2022 me objekt vendosjen e rregullave normative të funksionimit të programit. Rregullorja përcakton misionin, objektivat e programit MP. MSHS, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tij, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkepunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për transferimet, për afatet kohore të studimit, etj. GJV konstaton se rregullorja e programit të studimit MP. MSHS. është një dokument i përshtatshëm për të orientuar informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit për aktorët e përfshirë në këtë program studimi.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit të studimit.-dokumentacioni shtesë në e-Ascal, 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit)</i></p> <p>Nga elementët e programit të studimit të përcaktuara në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar</p>



	<p>rezulton se Plani mësimor i programit të studimit është një dokument informues cilësor mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>(2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit MP.MSHS. përmban planin mësimor sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor /jashtë auditorit.</p> <p>Nga analiza e planit mësimor rezulton se programi i studimit MP.MSHS. është organizuar në 4 semestra, me një total prej 120 kreditesh. Në vit të parë realizohen 9 lëndë, secila me peshën të shprehur në orë dhe në kredite përkatëse, me një ngarkesë totale prej 60 kredite. Në vitin e dytë gjithashtu, realizohen 9 lëndë secila me peshën të shprehur në orë dhe në kredite përkatëse, me një ngarkesë totale prej 60 kreditesh. Totali i orëve mësimore vjetore është 1500 orë. Orët mësimore organizohen në orë në auditor (leksione, seminare, laborator) dhe në orë studimi individual.</p> <p><i>(2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga elementët e programit të studimit të përcaktuara në Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, programi i studimit në rregulloren e Programit të studimit duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit Mp. MSHS. (2022) përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit te studimit.-dokumentacioni shtesë në e-Ascal)</i></p> <p>Gjithashtu, nga Vizita në institucion GVJ u informua se kriteret e pranimit bëhen publike në faqet zyrtare të UniBA.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html">https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme</p>	<p>DSHETP dëshmon nëpërmjet dokumentacionit shoqërues të RVB-së se mban në mënyrë sistematike elementët thelbësorë të dosjes së programit të studimit MP. MSHS., por në të nuk gjenden</p>

<p>për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>informacionet e nevojshme për të gjitha programet lëndore të këtij programi studimi, veçanërisht ato të kurrikulave të shkencave sociale dhe të aftësisimit praktik në Shkenca Sociale. Gjithashtu, në Planin mësimor të programit të studimit evidentohen për secilën lëndë dhe për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me VKM 41, të ndryshuar.</p> <p><b><i>Gvj-ja sugjeron krijimin e dosjes së plotë të programeve lëndore të programit të studimit në përputhje me kërkesat e VKM 41 dhe me objektivat e programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale”.</i></b></p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 10, 3. dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se programi i studimit MP. MSHS është një program studimi i hapur për herë të parë në vitin akademik 2022-2023, dhe të diplomuarit e parë në këtë program studimit do të jenë në vitin akademik 2023-2024, për rrjedhojë nuk mund të dëshmohet ndryshim i përmbajtjes së programit të studimit në një kohë kaq të shkurtër. GVJ-ja vëren se rekomandimet e lëna në Urdhrin e hapjes së programit të studimit MP. MSHS. Nr. 1760/2, datë 04.10.2022 për rishikimin e titullit dhe për rrjedhojë përmbajtjes së lëndës “Metodat e avancuara të kërkimit”, e cila në planin mësimor të programit të studimit duhet të ishte ndryshuar në “Metodat e kërkimit në edukim” nuk janë aplikuar.</p> <p><b><i>GVJ-Sugjeron që lënda “Metodat e kërkimit të avancuara” të ndryshohet në “Metodat e kërkimit në edukim” dhe tekstet e përdorura për lëndën të përkojnë me Metodat e kërkimit në edukim.</i></b></p> <p><b><i>Referuar edhe kriterit 4 të këtij standarti, GVJ-ja sugjeron përmirësimin e dosjes së programit me dosjen e plotë me programet lëndore të çdo lënde të pasqyruar në planin mësimor të programit të studimit.</i></b></p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 10, 3. dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe praktikave të evidentuara gjatë vizitave në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional si njësi përgjegjëse bazë për ofrimin e programit të studimit MP. MSHS përmbush kryesisht standartin mbi elementët e programit të</i></p>

	<p><i>studimit, të cilët transmetojnë informacion mbi përmbajtjen, organizimin, kriteret e pranimit dhe strukturën tek aktorët që ndërveprojnë në këtë program studimi.</i></p> <p><b><i>GVJ sugjeron që DSHETP të konsiderojë rekomandimin e lënë që në urdhrin e hapjes së programit të studimit mbi lëndën e “Metodave të kërkimit në edukim” si dhe ofrimin e dosjes së plotë të programeve lëndore për çdo lëndë/modul që përmban plani mësimor i programit të studimit.</i></b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<p><b>Standardi II.4</b></p> <p><b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ pas njohjes me planin mësimor të programit të studimit, programet lëndore sipas tipeve të veprimtarive konstaton se e ka të vështirë të arsyetojë në lidhje me mënyrën se si kurrikula kontribuon në thellimin e njohurive dhe aftësive për tu specializuar si mësues në fushën e shkencave sociale. Plani mësimor karakterizohet nga emërtesa të përgjithshme lëndore si “Kurrikula e Shkencave Sociale”, “Didaktika në Shkenca Sociale” dhe mungesa e programeve lëndore të moduleve respektive të këtyre lëndëve nuk e mundëson një analizë të tillë.</p> <p><b><i>GVJ-ja sugjeron përmirësimin e dosjes së programit të studimit me programet lëndore të çdo lënde të pasqyruar në planin mësimor të programit të studimit.</i></b></p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 10, 3. dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit MP. MSHS. është i organizuar në 13 lënde dhe module lëndore, praktikë profesionale dhe aftësim praktik në Shkenca Sociale të shtrirë në të dy semestrat e vitit të dytë akademik dhe nga detyrimet përmbyllëse të ciklit të studimeve. Në mbërritje të objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të të mësuarit dhe kërkimit shkencor në fushë dija është ndërtuar në koherencë logjike duke</p>

<p>rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>filluar me lëndë të fromimit të përgjithshëm dhe në mënyrë të gradualshme, duke ndërtuar dijen semestër pas semestri në lëndët e formimit të specializuar.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 9, tabela 10; 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në strukturën e programit të studimit lëndët organizohen sipas tipeve të veprimtarive formuese dhe orët mësimore të tyre ndahen në orë teorike të organizuara kryesisht në leksione dhe seminare dhe orë praktike. Zakonisht më shumë se gjysma e orëve mësimore të një lënde i dedikohet punës së pavarur të studentit sipas përcaktimeve të VKM 41.</p> <p><b><i>GVJ vlerëson se duhet të rishikohet ngarkesa e veprimtarive praktike në përputhje me përcaktimet e VKM 41 si dhe të ndërtohet paketa e programeve lëndore, nëpërmjet të cilës të mund të "lexohet" aftësia e programit të studimit për formim të thelluar në profesionin e mësuesit të Shkencave Sociale dhe në funksion të ndërtimit të aftësive dhe kompetencave për këtë profil mësuesie.</i></b></p> <p><i>(3. dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP. MSHS. është i organizuar në lëndë dhe module sipas veprimtarive formuese, në orë teorike dhe praktike që mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe në të cilin lëndët janë të vlerësuara sipas "Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve" (ECTS) duke mundësuar transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve.</p> <p>Gvj-ja konstaton nga dokumentacioni në dispozicion dhe vizita në institucion se në programin e studimi MP. MSHS nuk ka patur transferime studimesh për periudhën 2022-2024 dhe as studentë, të cilët kanë kryer programe mobiliteti.</p> <p><i>(2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf, 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +.pdf, 13.b. Shkëmbimet Erasmus+.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e</p>	<p>Sipas praktikave të punës së dëshmuara gjatë vizitave në institucion pedagogët përgjegjës të lëndëve priren të përmirësojnë në proces përbajtjet lëndore dhe t'i pasurojnë programet lëndore me burime literature sa më bashkëkohore. Titullarët e lëndëve janë përgjegjës për përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të programit të studimit, duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe</p>



<p>tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>ndihmëse të pesë viteve të fundit, të cilën e propozojnë edhe për sigurim fondi në bibliotekën e UniBA.”.</p> <p><i>(4. Rregullore e Dept. Shkencave te Edukimit dhe Trajnimit Profesional.pdf- dokumentacioni shtesë në e-ascal, 30. Lista e teksteve në Bibliotekë.pdf, informacion nga vizitat në institucion 19-20 mars 2024)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p><b>Në analizë të dosjes së vënë në dispozicion GVJ-ja konkludon se përmbajtja e programit të studimit MP. MSHS duhet të plotësohet me programet lëndore respektive të lëndëve të shkencave sociale në përputhje me planin mësimor të programit të studimit për të arsyetuar rreth dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</b></p> <p><i>(3. dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf, 5. Rregullore e programit te studimit.pdf-dokumentacioni shtesë në e-ascal))</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Studentët që diplomohen në programin e studimit MP. MSHS. pas studimeve mund të punësohen si mësues të shkencave sociale në Arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë në institucione të arsimit parauniversitar në republikën e Shqipërisë dhe vende të tjera shqipfolëse. Ky program studimi është hartuar bazuar mbi një analizë tregu pune dhe në përgjigje të nevojave për mësues të profilit të shkencave sociale.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit te studimit.pdf-dokumentacioni shtesë në e-ascal, 4. Studimi i tregut të punës MPMSHS.pdf)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se përgjithësisht struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve.</i></p> <p><b><i>GVJ sugjeron të rishikohet me prioritet paketa e plotë e programeve lëndore dhe moduleve lëndore, të cilat ndërtojnë gjithë përmbajtjen e programit të studimit dhe zërthejnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që synon të formojë tek mësuesit e ardhshëm të shkencave sociale ky program studimi.</i></b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



<b>Standardi II.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ konstaton se në praktikën e DSHETP hapësirat më të rëndësishme dedikuar analizës së programeve të studimit janë analizat vjetore të punës dhe raportet e vetëvlerësimit për programet e studimit. Gjithashtu, gjatë takimeve në institucion GVJ evidenton se DSHETP mban takime periodike me aktorë të ndryshëm të përfshirë në realizimin e programit të studimit si: personeli akademik me kohë të pjesshme, rrjeti ALUMNI, institucionet partnere të praktikave dhe aktorë të tjerë të tregut të punës. Gjatë vizitave në institucion u dëshmuua se institucioni mban në mënyrë të vazhdueshme kontakte me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës dhe të diplomuarit, sugjerimet dhe reflektimet e të cilëve i shpërndan më njësinë bazë për të reflektuar në përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës.  <i>(48.1. Raport vjetor per vleresimin e cilesise ne UniBa, 4. Studimi i tregut të punës MPMSHS, Aneks RVB-tabela 5; informacion nga vizita në institucion 19-20 mars 2024)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në takimin me studentë të programit të studimit MP. MSHS. gjatë vizitës në institucion në datën 19.03.2024, GVJ konstaton se studentët mbajnë kontakte të rregullta me departamentin dhe kanë hapësirat e tyre të shprehjes së mendimeve rreth kurrikulës së programit të studimit, programeve lëndore dhe formave të vlerësimit. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional nxit përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve për t'u angazhuar në dhënien e sugjerimeve që do të përmirësonin ofertën akademike të programit të studimit. <i>(Informacion nga vizita në institucion, 19.03.2024; 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit_Sem I)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në	Programi i studimit MP. MSHS. është një program i ciklit të dytë të studimeve në fushën e mësuesisë. Njësia përgjegjëse dëshmon se ndjek zhvillimet në arsimin parauniversitar dhe në strategjinë e zhvillimit të saj e ka për fokus përshtatjen e ofertave akademike të studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet më të fundit ardhur nga strukturat e profesionistëve vendas dhe ndërkombëtarë.

bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	(5. Strategjia e zhvillimit të Departamentit)			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vëren se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dhe Universiteti "Barleti" nxisin përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, në diskutime me studentët dhe strukturat e tyre, mbajnë kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit dhe programeve lëndore, dhe i reflekton ato kur janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit MP. MSHS., neni 3 përcaktohen qartë objektivat dhe prioritetet kryesorë të studimit dhe të kërkimit shkencor. Ky program studimi ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe të zhvillimit të Departamentit, të cilët synojnë ofrimin e programeve cilësore në fushën e mësuesisë. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional është një departament me fokus në ofrimin e programeve të ciklit të dytë "Master" në Mësuesi. (Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të Departamentit, 10. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, 5. Rregullore e programit të studimit-Dokumentacioni shpesë në e-ascal)
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe	GVJ konstaton se në rregulloren e UniBA, në nenin 3. Parimet deklarohet se: "Aktiviteti në UniBA udhëhiqet nga fryma e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të sanksionuara në aktet juridike kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim eliminimin e çdo praktike jodemokratike, diskriminuese apo denigruese ndaj stafit akademik, studentëve dhe stafit administrativ në tërësi." Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe praktikave të punës të




fushën e veçantë të studimit.	<p>prezantuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se FSHSTS dhe DSHETP nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e UniBa.pdf, neni 3: Parimet; informacion nga vizita në institucion, 19-20 mars 2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Përgjatë veprimtarisë akademike të programit të studimit MP. MSHS, studentët kanë një vëmendje të dedikuar që është shprehje e prioritetëve të Universitetit Barleti, Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, dhe të punës së përditshme të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. UniBa, ka organizuar konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Science for youth” 30 maj 2022. Gjithashtu nga të dhënat bashkëshoqëruese të RVB-së konstatohet angazhimi i të paktën 13 studentëve në punime shkencore me pedagogë të tyre. Gjithashtu, studentët nxiten dhe motivohen për të qënë pjesë aktive e trajnimeve dhe projekteve të ndryshme me fokus studentët.</p> <p><i>(13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar. 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe ëorkshopeve.pdf; Anekse RVB-tabela 22)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional mbështetet financiarisht nga institucioni për realizimin e veprimtarive studimore, kërkimore e shkencore në forma të ndryshme, ku më kryesorja është përfshirja në grupe kërkimore në projekte në zbatim nga Institutet në strukturën e UniBA, Publikimi pa pagesë në kuadër të veprimtarive kërkimore, Mbështetja financiare në realizimin e konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare, duke mbuluar kostot administrative dhe konstot e botimit të paketës së dokumentave të konferencës për pjesëmarrësit, UniBame propozime të njësisë bazë mbështet financiarisht pasurimi në fondit të ibrave dedikuar profilit të studimeve në fushë të mësuesisë, UniBa nëpërmjet politikave të saj siguron akses në library online dhe në platforma digjitale literature si JSTOR, SEARCH4LIFE, etj.</p> <p><i>(30.a. Të dhëna të plota për platformat online te Bibliotekes, 30.c. Platforma e bibliotekës online, 10. Strategjia e zhvillimit</i></p>

	<i>Institucional 2020-2030, Aneke RVB-tabela 17)</i>			
<b>Konkluzione</b>	Në përfundim të analizës së kriterëve të standartit II.6, GVJ konkludon se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional që ofron programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Shkenca Sociale" garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, duke siguruar lirinë akademike, autonominë, mbështetjen e duhur për realizimin e objektivave të studimit, kërkimit shkencor dhe mbështetjen për realizimin e prioriteteve strategjike të programit të studimit mbi studimet, kërkimin shkencor dhe mbështetjen e studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standartit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konstaton se zhvillimi i partneriteteve për të realizuar veprimtari kërkimore shkencore të përbashkëta është në fokus të prioriteteve strategjike të UniBA, FSHSTS dhe DSHEP. Në gjithë hierarkinë e strukturave të UniBA dëshmoheq qartë fryma e bashkëpunimit. Edhe FSHSTS/ DSHEP si njësia Kryesore dhe njësia bazë e ofrimit të programit të studimit MP. MSHS. mbështesin grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe sigurojnë bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. <i>(Evidenca 13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar, Evidenca 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +.pdf Aneke RVB-tabela 19)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Mp. MSHS dhe DSHEP rezulton të jenë të angazhuar në përgjigjen e kërkesave të aktorëve të tjerë për analiza, kërkime, studime e projekte kërkimore shkencore në të cilin angazhojnë edhe studentë. Nga të dhënat rezulton se: Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv për programin e studimit është 13; Numri i projekteve të zbatuara në rang Departamenti rezulton të jetë 3 (tre);



	<p>Numri i pjesëmarrjeve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare rezulton të jetë 19;</p> <p>Numri i pjesëmarrjeve në aktivitetet shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit për prezantime të punimeve kërkimore shkencore rezulton të jetë 36;</p> <p>Numri i studentëve të angazhuar në punime shkencore individuale të pedagogëve rezulton të jetë 13.</p> <p><i>(Aneksë RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Në vijim të analizës së përbushjes së standarteve të vlerësimit GVJ vlerëson se në fushën e programit të studimit DSHETP/FSHSTS/UniBA organizojnë konferenca dhe aktivitete që ndihmojnë arritje ne objektivave të programit të studimit për studentët dhe personelin akademik. Ndër të tilla aktivitete mund të përmendim:</p> <p><b>INOVACIONI NË EDUKIMIN DIGJITAL: EVENTI DIGIEDUHACK 2023 NGA UNIVERSITETI BARLETI</b></p> <p>Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Science for Youth"</p> <p>Leksione të hapura lidhur me tema si "Gjithëpërfshirja në arsim", "Kërkimi Shkencor", etj</p> <p><i>(13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar., Aneksë RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22; 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe ëorkshopeve.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit MP. MSHS. është ndërtuar mbi modele ekzistuese të kurrikulave të së njëjtës fushë studimi dhe përgjithësisht përbush kërkesat e tregut kombëtar për mësues të shkencave sociale.</p> <p><b>GVJ-ja sugjeron që për vlerësimin e tregut të punës Institucioni të hartojë një studim të mirëfilltë tregu pune për programin e studimit MP. MSHS.</b></p> <p><i>(4. Studimi i tregut të punës MPMSHS; Evidenca 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së</p>	<p>Programi i studimit MP. MSHS. ofruar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe trajnimit Profesional formon mësues për Arsimin e mesëm të lartë dhe Arsimin e mesëm të ulët në Shkenca Sociale. Mësuesia është profesion i rregulluar dhe njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga institucionet e zhvillimi të arsimit parauniversitar.</p> <p><b>GVJ-ja vë re se në kriteret e pranimit për programin e studimit nuk janë përcaktuar drejtimit e studimit të ciklit të</b></p>



profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<b>parë që duhet të ketë kandidati për student në këtë program studimi. Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi moszbatimi i kriterëve të përcaktimit të llojit të diplomës së ciklit të parë mund të rrezikojë licencimin e të diplomuarve dhe për pasojë mos ushtrim të profesionit.</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	<i>(Dokumentacioni shtesë në e-ascal- 5. Rregullore e programit të studimit.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit garanton njohuri të qëndrueshme në fushën e studimeve "Mësues në Shkenca Sociale", ofron mundësi për t'u integruar në mjedisin kërkimor shkencor kombëtar e ndërkombëtar siguruar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit si dhe veprimtarive me karakter kërkimor shkencor të përbashkëta nga UniBAE, FSHSTS dhe DSHETP.</i> <i>Gvj-ja sugjeron hartimin e një studimi tregu pune të mirëfilltë për programin e studimit si dhe rishikimin e kriterëve të pranimit, duke përcaktuar drejtimin e diplomës së ciklit të parë të studimeve për kandidatët për studentë në mënyrë që të mos riskohet në moslicencimin e tyre si mësues pas përfundimit të studimeve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit përmban peshën specifike të orëve të leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave institucionale dhe orëve individuale për çdo lëndë të programit të studimit MP. MSHS. Nga ana tjetër, programi i lëndës përmban objektivat, konceptet themelore të lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, detyrimet e studentit për punime individuale si ese ose detyra kursi, detajimin e përmbajtjes së lëndës sipas orëve në dispozicion për cilindo komponent mësimor si leksione, seminare, praktika e laboratore. Të gjithë komponentët e planit mësimor të programit të studimit MP. MSHS. dhe të programeve lëndore janë të miratuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik.</p> <p><i>(Aneksët e RVB-tabela 10, tabela 9, tabela 13, tabela 15; 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi programet e lëndëve GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit planifikon dhe përdor një larmi formash mësimdhënieje për të trajtuar materialin mësimor në mënyrë të larmishme, duke e diferencuar edhe sipas nevojave të studentëve. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentë të progamit të studimit, GVJ evidentoi zbatimin praktik të mënyrave të shumta të mësimdhënies si tryeza të rumbullakëta, punë në grup, debate mbi tema të caktuara, ese, projekte minikërkimore, etj. Teknika mësimdhënieje që favorizojnë të mësuarin efektiv dhe që është një tregues pozitiv për respektimin e larmisë së nevojave të studentëve.</p> <p><i>(informacion nga vizita në institucion 19-20 mars 2024, 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MP. MSHS. ka një karrierë akademike të konsoliduar dhe është i kualifikuar në Institucione brenda dhe jashtë vendit. GVJ konstaton se pavarësisht formimit profesional të personelit akademik të programit të studimit, UniBa ka praktika të mira në mbështetje të përmirësimit të kompetencave didaktike të personelit akademik në funksion të përmirësimit të cilësisë së të</p>

	<p>mësuarit. Ndër të tilla praktika mund të përmendim tryezat e rrumbullakëta, workshopet, leksionet e hapura, mbajtjen e konferencave shkencore, trajnimeve nëpërmjet programeve të shkëmbimit ERSAMUS+ dhe periudhave të mësimdhënies në kuadër të ERASMUS +, të cilat krijojnë kushtet për përmirësim të kompetencave didaktike dhe përditësim të tyre.</p> <p><i>(13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar, 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe ëorkshopeve; Anekse RVB-tabela 19; 13.b. Shkëmbimet Erasmus+, 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +; 7.2. CV e Stafit Akademik.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit MP. SHS. kanë kualifikime dhe kontribute universitare, artikuj të botuar në revista shkencore vendase e të huaja, pjesëmarrje në konferenca e kongrese shkencore, sipas fushave të ekspertizës së angazhimeve të tyre në procesin mësimor. Nga struktura e programeve lëndore, përmbajtja e tyre dhe nga dëshmitë e studentëve gjatë takimeve në institucion GVJ mund të konkludojë se personeli akademik i programit të studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve lëndore. Studentët dëshmojnë gjatë takimeve në institucion përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin. Metodatat e mësimdhënies karakterizohen nga ndërveprimi me në qendër studentin nëpërmjet metodave të ndryshme si: case study, role play, debat, brain storming, etj. Gjatë mësimdhënies rezulton që edhe teknologjia luan një rol të rëndësishëm, duke mundësuar prezantimin e materialeve mësimore audio-vizive, të cilat sigurojnë një mjedis të qëndrueshëm të nxëni të orientuar me në qendër studentin dhe të udhëhequr e mbështetur nga pedagogu në mënyrë që studentët të krijojnë argumenta dhe analiza të qëndrueshme teorike, duke respektuar mendimin e lirë dhe duke konsoliduar respektin ndaj njëri-tjetrit.</p> <p><i>(Anekse RVB-tabela 19; 7.2. CV e Stafit Akademik., informacion nga vizita në institucion, 3. Programet lëndore (Syllabuset) - dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Departamenti i</p>

<p>për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dëshmon se në komponentët e vlerësimit të punës së departamentit mësimdhënia dhe cilësia e saj është një nga shtyllat bazë. Në praktikat e punës DSHETP dëshmon se si njësi përgjegjëse e programit të studimit ka ndërmarrë iniciativa për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe duke reflektuar sugjerimet e tyre në procesin e punës. DSHETP dëshmon se në praktikën e saj të punës bën përpjekje nëpërmjet bisedave të drejtpërdrejta me studentë ose edhe pyetësorëve individualë mbi personelin akademik dhe mësimdhënien të bëjë vlerësime të tilla.</p> <p><i>(48.1. Raport vjetor per vleresimin e cilesise ne UniBa, 20.4. Formular i vleresimi i studentëve për lëndën, Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Universiteti “Barleti” është institucion aktiv në ofrimin e trajnimeve të formimit të vazhduar për mësuesit si dhe institucion i angazhuar në ofrimin e shkollës për drejtuesit e arsimit parauniversitar. Në këto përvoja UniBa dëshmon dëshmon se në nivel institucional nxit, promovon dhe ngre struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura janë qendra të inovacionit dhe përgjegjëse për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p><i>(13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar, 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve;)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, RVB-së dhe vizitës në institucion, konstaton se Universiteti “Barleti”, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, dhe Departamenti i Shkencave të edukimit dhe Trajnimit Profesional garantojnë krijimin e strukturave, politikave dhe mundësive që krijojnë kushte të përshtatshme për mësimdhënie inovative dhe në respekt të diverzitetit të studentëve, si dhe nxisin procesin e të mësuarit</i></p>



	<i>efektiv dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sipas rregullores së programit të studimit, Kreu III: Vlerësimi i studentit, kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Sipas nenit 17, pika 2. “Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testeve/ provimeve me shkrim/ me gojë ose i kombinuar; me detyra kursi/projekte/ postera dhe në shumëllojshmëri formash vlerësimi. Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/ modulit dhe vlerësimi në provën përfundimtare. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/ modulet e cilësuara provim në planin mësimor përfaqëson 20-50% të vlerësimit përfundimtarë” Format e kontrollit të dijeve dhe pesha respektive e tyre përcaktohen në programin e lëndës.  <i>(5. Rregullore e programit të studimit- dokumentacioni shtesë në e-asca; 1.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit, anekse RVB-tabela 15, 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-asca)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Nga dokumentacioni i prezantuar me RVB-në, rezulton se plani mësimor i programit të studimit MP. MSHS. përmban formën e vlerësimit përfundimtar të njohurive në përfundim të lëndës. Gjithashtu, rezulton se në çdo program lënde të hartuar nga titullarët e lëndëve është parapërcaktuar dhe miratuar metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara për lëndën.



lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Nga takimet me studentët rezultoi se në javën e parë të çdo semestri studentëve ju prezantohen nga pedagogët e lëndës syllabuset e lëndëve/ moduleve duke konsideruar në mënyrë të kujdesshme kompetencat e lëndës, objektivat dhe qëllimet lëndore, rezultatet e të mësuarit, metodat e mësimdhënies, metodologjinë dhe komponentët e vlerësimit të studentit dhe dijeve të tij profesionale në përfundim të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe e rekomanduar për studim.</p> <p><i>(informacion nga vizita në institucion, 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-ascal, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në proces nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe komponentëve të tij dhe vlerësimit përfundimtar. Mënyrat e vlerësimit të studentit synojnë t'i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, për këtë arsye përdoren si metoda vlerësimi detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, projektet, analizimi i rasteve, esetë, dorëzim dosje, praktika, etj. Kontrolli i njohurive përcaktohet sipas rregullores së UniBA edhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Testimi përfundimtar mund të zhvillohet me shkrim, me gojë, ose në mënyrë të kombinuar, sipas parashikimeve dhe miratimit në programin e lëndës/ modulit.</p> <p><i>(3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-ascal, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale, Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa, 5. Rregullore e programit të studimit- dokumentacioni shtesë në e-ascal)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UniBa, FSHSTS në rregulloret institucionale dhe DSHETP në rregulloren e programit të studimit për MP. MSHS. kanë hartuar dhe zbatojnë procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>	

**Standardi III.3**

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas rregullore së programit të studimit, kreu III, vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/ modulit dhe vlerësimi në provën përfundimtare provim/ testim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuar provim në planin mësimor përfaqëson 20-50% të vlerësimit përfundimtar. Elementët, pesha specifike në përqindje të notës përfundimtare, dhe format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe testimit përfundimtar shprehen në mënyre eksplicite në programet e lëndëve. Në rregulloren e programit të studimit MP. MSHS. shprehet qartë se vlerësimi përfundimtar i shprehur në notë i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë semestrit, bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit si pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit te studimit, kreu III; 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shitesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, anekse rvb- tabela 15)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UniBa nëpërmjet dokumentacionit të depozituar me dosjen e vetëvlerësimit dëshmon se praktikat e implementimit të sistemeve elektronike të testimit janë implementuar si fillim si të imponuara nga kushtet specifike të pandemisë gjatë përdorimi të platformave të mësimdhënies online si: google clasaroom, google meet, zoom. Institucioni është duke punuar për adaptimin e një sistemi të qëndrueshëm për vlerësim elektronik.</p> <p><i>(38. Manual perdorimi i Google Classroom per pedagogje, 38.h. Udhezues per provimet ne Google Forms.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas neneve 17-21 të Rregullore së programit të studimit vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj dhe kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet e parashkuara në rregulloren e studimeve dhe në programin e lëndës. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet sipas sistemit të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë).</p> <p><i>(5. Rregullore e programit te studimit, kreu III; 3. Programet</i></p>

	<i>lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve, anekse rvb- tabela 15)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ konstaton se në të gjitha format e vlerësimit të njohurive të fituara, vlerësimi i studentit shoqërohet me komente mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta në dijet e mësuara dhe aftësitë e përvetësuara në mënyrë që të ndërtohen strategji të suksesshme për të rirorientuar të mësuarin efektiv për të arritur rezultate më të larta në vijim. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe provimet e ndërmjetme u evidentuan nga takimet me student dhe personelin akademik si element të rëndësishëm të procesit të “korrigjimit” të mangësive nëpërmjet shkëmbimit të komenteve të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e rezultateve të studentit në provën finale dhe në të ardhmen.  <i>(Informacion nga vizita në institucion, 5. Rregullore e programit të studimit, kreu III, neni 21; 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve, anekse rvb- tabela 15))</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Senati akademik i UniBA me vendim nr. 24, datë 3.07.2023 ka miratuar Kodin e etikës të Universitetit “Barleti”, i cili sipas Kreut II, Neni 4: Parimet, zbatohet gjatë veprimtarisë në UniBA nga i gjithë personeli akademik, kërkimor shkencor, ndihmës akademik dhe studentët e UniBa-së. Në Kodin e Etikës parashikohen parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore ndër të cilat edhe ndalesat ndaj plagjiaturës dhe kopjimit në detyra e provime. Kriteret dhe kërkesat mbi sjelljet etike janë të parashtruara edhe në programet e lëndëve të programit të studimeve sipas VKM 41 të ndryshuar në seksionin “kodi i etikës”. <i>(33. Kodi i Etikës, 3. Programet lëndore (Syllabuset)- dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Transparenca me studentët në lidhje me komponentët e vlerësimit dhe peshën specifike të secilit komponent në vlerësimin e bën rezultatin e kontrollit të dijeve dhe të aftësive profesionale të bazuar në meritë dhe në skema racionale që minimizojnë ndikimet subjektive. Sipas neni 21: Dokumentimi i vlerësimit të Rregullores së programit të studimit, vlerësimet e studentëve dorëzohen në sekretari brenda 5 ditëve nga dita e provimit. Procesverbali, i plotësuar me rezultatin e provimit, dorëzohet në sekretarinë mësimore i nënshkruar nga komisioni përkatës dhe pa korrigjime. Gjatë takimit me student, rezultoi se afatet e

	informimit të vlerësimit respektohen me korrektësi nga personeli akademik programit të studimit MP. MSHS.  <i>(Informacion nga vizita në ishtëtitucion, 5. Rregullore e programit të studimit, kreu III, neni 21)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rregullorja e programit të studimit parashikon të drejtën për ankimim të rezultatit dhe procedurës së vlerësimit dhe realizimit të provimit nga ana e studentit, duke garantuar të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Ankimimi duhet të bëhet brenda 24 orëve nga njohja me vlerësimin.			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga GVB-ja, personeli akademik i programit të studimit dhe studentët u evidentua se nuk ka patur student, të cilët kanë ndjekur procedurën e ankimit sipas rregullores së studimeve të UniBA. Në praktikën e komunikimit të vlerësimit në programin e studimit evidentohen ura të mira komunikimi që ju mundësojnë studentëve të jenë ballë për ballë me pedagogun e lëndës në momentin e komunikimit të vlerësimit dhe të konsultimit të menjëhershëm të çdo pakënaqësie të mundshme mbi vlerësimin.  <i>(Informacion nga vizita në ishtëtitucion, 5. Rregullore e programit të studimit, kreu III, neni 21)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se Universiteti "Barleti" nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të rregulloreve të brendshme institucionale dhe të programit të studimit siguron një mjedis ndërveprimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve që mundëson dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit MP. MSHS. është një program i ciklit të dytë të studimeve “Master” në mësuesi në shkencë sociale. Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një kurrikule të pasur si në aspektin teorik edhe në atë praktik. Në analizë të planit mësimor të programit të studimit, rezulton se programi garanton thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Programi i studimit ofron një kurrikulë, e cila në mënyrë të përshkallëzuar dhe të strukturuar integron dijet e formimit psiko-pedagogjik, lëndët e formimit karakterizues e ndërdisiplinar. Për thellimin e dijeve në praktikën profesionale, studentëve ju garantohen praktika profesionale mësimore në institucione të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Aftësitë shkencore dhe dijet në fushën e kërkimit studentët i testojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të lëndëve nëpërmjet projekteve të kursit dhe detyrave kërkimore.</p> <p><i>(Aneksat e Rvb- tabela 9, tabela 10, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit MP. MSHS. nëpërmjet strukturës së tij formative dhe përmbajtësore përpos synimit për të formuar profesionistë të specializuar në fushën e mësuesisë garanton edhe zhvillimin e dimensioneve të tjera humane, sociale e komunikative të studentëve që ndjekin programin e studimit. Në lëndë dhe module lëndore si: Zhvillimi i kurrikulës dhe mendimi kritik, menaxhim i klasës, TIK në mësimdhënie dhe të nxënë, Edukimi dhe bashëpunimi me prindërit, etj. në themel të tyre kanë aspektet komunikative, humane dhe sociale të cilat sigurojnë sfondin e ndërveprimit profesional. Teknologjia e informacionit rezulton të jetë një aset jo vetëm në ndihmesë të informacioneve ndihmëse në funksion të programit të studimit, por edhe në funksion të zhvillimit të aftësive të komunikimit digjital për mësimdhënie dhe të nxënin. Në programet lëndore fondi i literaturës së detyrueshme dhe më shpesh literaturës së rekomanduar është në gjuhë të huaj, kryesisht gjuhën angleze, duke krijuar kështu një mundësi të shtuar për studentët e programit të studimit për të zhvilluar aftësitë e tyre edhe gjuhë të huaj në përputhje me fushën e studimeve.</p> <p><i>(Aneksat e Rvb- tabela 9, tabela 10, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale; 3. Programet lëndore (Syllabuset)-dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p><i>lëndëve)</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me RVB-në, GVJ-ja konstaton se në syllabuset e çdo lënde, në javën e fundit të procesit mësimor ka një temë përmblyëse në funksion të evidentimit të koncepteve, kompetencave dhe aftësive kryesore të fituara gjatë kursit lëndor. Në orën e fundit të mësimin personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe jep udhëzimet përkatëse për detyrimet përmblyëse të lëndës/modulit. Një fakt i tillë u evidentua edhe gjatë bisedave më studentë të programit të studimit.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion; 3. Programet lëndore (Syllabuset)-dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe në analizën e kritereve të standardit III.1, metodat e mësimdhënies në programin e studimit MP. MSHS. janë të orientuara me në qëndër studentin dhe synojnë të mësuarin aktiv. Në funksion të këtij qëllimi zhvillimi i mësimdhënies mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të servitura për diskutim nga përvoja të punës duke krijuar klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Gjatë vizitave në institucion rezultoi se studentët kanë qënë të angazhuar në veprimtari të ndryshme të karakterit kërkimor dhe profesional dhe njohuritë e fituara gjatë programit të studimit kanë qënë një bazë e shëndetshme që ata të kishin kompetenca profesionale për të çuar përpara angazhimet e marra.</p> <p><i>(Anekset e Rvb-së-tablea 5, 2.1.b. Plani mësimor_Mesuesi ne Shkenca Sociale; 3. Programet lëndore (Syllabuset)-dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Personeli akademik i programit të studiimit MP. MSHS. është vazhdimisht i interesuar për të qënë pjesë e diskutimeve shkencore mes profesionistëve të fushës duke marrë pjesë në aktivitete shkencore si brenda edhe jashtë vendit, duke u informuar mbi zhvillimet e reja në fushën e tyre të ekspertizës</p>

<p>brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>dhe në fushën e studimeve pedagogjike dhe në fushë të shkencave sociale.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit dëshmon të jetë një urë lidhëse ndërmjet informacioneve më të fundit të shkencës dhe teknologjisë dhe studentëve të programit të studimit. Personeli akademik i integron këto dije në strukturën e programeve lëndore dhe temave mësimore ose i shpërmdan këto njohuri nëpërmjet orëve të hapura të zhvilluara edhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke qënë të angazhuar vetë si lektorë ose edhe duke ftuar kolegë vendas e të huaj ekspertë në fusha të ndryshme që lidhen me programin e studimit.</p> <p><i>(Anekse RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22; 21. Raport vjetor i punes kerkimore 2021-2022 dhe 2022 - 2023. 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve, 13.a. Linqet e Veprimtarive të Departamentit për Trajnime dhe Pedagogë të Ftuar, Evidenca 7.2. CV e Stafit Akademik)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të Institucionit dhe në strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit studentët dhe veprimtaritë me në qëndër studentin janë prioritete strategjike, të cilat ndër të tjera synohen të realizohen edhe nëpërmjet mbështetjes së tyre për zhvillimin e ideve dhe projekteve dhe studimeve të përparuara kërkimore nga studentët. UniBa dëshmon praktika pozitive në këtë drejtim duke i përfshirë studentët në projekte kërkimore të fituara nga personeli akademik i departamentit dhe duke financuar konferenca të dedikuara studentore si forume diskutimi në fushën e tyre të studimeve.</p> <p><i>(Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030, 5. Strategjia e zhvillimit te Departamentit; Anekse RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22; 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve të standartit III.4 konkludon se programi i studimit MP. MSHS. garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe duke realizuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standartit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.5**

<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Universiteti “Barleti” në nenin 62 të rregullores së tij përcakton formën e detyrimeve përmbyllëse varësisht nivelit të diplomave që ofrohen në këtë Universitet. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, gjithashtu në Rregulloren e studimeve në nenin 14 përcakton procedurat e Diplomimi, të cilat trajtohen edhe në rregulloren e programit të Studimit. Në këto rregullore përcaktohet qartë se:</p> <p>Për të fituar diplomën për programin e studimit të kryer, studenti duhet të ketë përfunduar detyrimet e parashikuara në planin mësimor të programit të studimit;</p> <p>Në programet e cilit të dytë të studimit “Master Profesional” studimet përmbyllen me provim përfundimtar formimi.</p> <p>Sipas akteve rregullative, në rastet kur studimet përmbyllen me provim të përgjithshëm përfundimtar Departamenti që ofron programin përgatit programin orientues për studentët.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit asiston studentët gjatë periudhës përgatitore për provën finale duke furnizuar materiale studimore ose duke ofruar asistime sipas kërkesës.</p> <p><i>(2.4. Fondi i pyetjeve, 2.6.a. Teze e provimit përfundimtar, 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit, 5. Rregullore e programit të studimit-dokumentacioni shtesë në e-ascal, 1.2. Rregullore e UniBa)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Fondi i pyetjeve për programin e provimit të formimit në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” ndërtohet bazuar në materiale dhe njohuri të dhëna gjatë viteve të zhvillimit të programit të studimit dhe lëndëve të tij respektive. Ky fond pyetjesh është përfaqësues i dijeve lëndore të marra në bllokun e formimit psiko-pedagogjik si dhe në lëndët e formimit karakterizues e ndërdisiplinar.</p> <p><i>(2.4. Fondi i pyetjeve, 2.6.a. Teze e provimit përfundimtar)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</p>	<p>Për programin e studimit MP. MSHS. prova finale realizohet nëpërmjet provimit të formimit. Sipas rregullores së programit të studimit, kur studentët kanë rezultate të larta gjatë programit të studimit (mbi 9.5), atëherë ata mund të zgjedhin të realizojnë temë diplome. Kërkesat e tyre miratohen me vendim Senati, dhe</p>

<p>Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>në këto raste DSHETP cakton udhëheqës për çdo student, i cili asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit të studimit-dokumentacioni shtesë në e-ascal, 2.4. Fondi i pyetjeve, 2.6.a. Teze e provimit perfundimtar)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit dhe rregullores së FSHSTS dhe UniBA rezulton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka gjithë suportin për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit në rastet e realizimit të provës finale me temë diplome.</p> <p><i>(2.4. Fondi i pyetjeve, 2.6.a. Teze e provimit perfundimtar, 1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit, 5. Rregullore e programit të studimit-dokumentacioni shtesë në e-ascal, 1.2. Rregullore e UniBa)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në nenin 17 të Rregullores së programit të studimit përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10) me pikë ose përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (Sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit të studimit-dokumentacioni shtesë në e-ascal)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit neni 23: Marrja e diplomës, përcaktohen procedurat dhe kriteret për pajisjen e studentit në përfundim të studimeve të cilit të dytë me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat janë të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, të cilat janë dokumente me të cilat studentit në mënyrë zyrtare pajiset në përfundim të studimeve.</p> <p><i>(5. Rregullore e programit të studimit-dokumentacioni shtesë në e-ascal, neni 23, 15. Template i Diplomes MP në MSHS-</i></p>



	<i>dokumentacioni shtesë ne e-ascal, 16. Suplementi i Diplomes MP në MSHS. - dokumentacioni shtesë ne e-ascal)</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Universiteti “Barleti” ka një rregullore të posaçme për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve në Institucion të detajuar në rregulloren për funksionimin e sekretarisë mësimore., të miratuar me vendim Senati Nr. 58, datë 10.03.2021. Kjo rregullore garanton që gjithë aktorët e përfshirë në jetën universitare të UniBA të trajtojnë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin e studentit dhe të konsiderojë politikat e mbrojtjes së të dhënave në administrimin e informacionit.  <i>(19.1. Rregullore per Funksionimin e Sekretarise Mesimore)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se Universiteti “Barleti”, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Departamenti i Shkencave Të edukimit dhe Trajnimit Profesional, kanë hartuar rregullore të të cilat përcaktojnë qartë procedurën e detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit MP. MSHS. dhe në përmbyllje të studimeve e pajisin studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përmbyllur plotësisht standartin III.5.</i>			
<b>Shkalla e përmbylljes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbyllet</b>	<b>Përmbyllet pjesërisht</b>	<b>Përmbyllet kryesisht</b>	<b>Përmbyllet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.6

**Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në komponentët e programit të studimit një zë të rëndësishëm kurrikular zë edhe aftësimi praktik i studentëve. Institucioni dhe njësia përgjegjëse e ofrimit të programit të studimit kanë një listë të pasur institucionesh të arsimit parauniversitar me të cilat bashkëpunojnë për ofrimin e praktikave profesionale në funksion të programit të studimit MP. MSHS. Gjithashtu, UniBA, pjesë e Barleti group, edhe brenda in stitucionit siguron mjedise interaktive për zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.  <i>(anekse rvb-tabela 5, 2.3. UniBa Paketa e praktikës, 22. Liste e</i>



	<i>marreveshjeve te Departamentit)</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimim më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Në kurrikulën e programit të studimit aftësitë praktike të studentëve sunohen të formohen nëpërmjet dy formave praktike: Aftësimi praktik në shkencë sociale dhe praktikës profesionale. Institucioni dhe njësi përgjegjëse dëshmojnë se bashkëpunojnë me institucione kompetente për garantimin e realizimit të praktikave profesionale me qëllim përfitimim e kompetencave profesionale për studentët e programit të studimit MP. MSHS.  <i>(anekse rvb-tabela 5, 2.3. UniBa Paketa e praktikës, 22. Liste e marreveshjeve te Departamentit)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Sikurse çdo komponent tjetër i veprimtarive formuese të planit mësimor të programit të studimit MP. MSHS., edhe komponenti i praktikave profesionale ekuivalentohen në kredite. Institucioni ka hartuar një paketë praktike në të cilën përshkruen modalitete të vlerësimit të praktikës nga ana e trajnerëve dhe mentorëve të praktikës.  <i>(2.3. UniBa Paketa e praktikës)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ-ja konstaton se për programin e studimit MP. MSHS. institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës profesionale dhe aftësimi praktik në Shkencë Sociale për të përmirësuar përvetësimin e kompetencave profesionale të studentëve në programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka**

**kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																																		
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Për zhvillimin e programit të studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në “Shkenca Sociale” (MPMSHS) për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar 6 pedagogë me kohë të plotë, ndërsa për zhvillimin e programit të studimit për vitin akademik 2023-2024 janë 5 pedagogë me kohë të plotë dhe 1 me kohë të pjesshme si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2023-2024 janë 5 personel akademik me kohë të plotë, nga këta 2 janë persone l akademik me titullin Prof.As.Dr, 2 me gradën “Doktor”, 1 PhD dhe një me titull “Msc”.</p> <p>Personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024 është vetëm 1 me titull “Doktor”.</p> <p>Gradat dhe titujt e stafit akademik përputhen me fushën e studimit, me lëndët dhe modulet. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Mp. MSHS rezulton të jenë të angazhuar në kërkime, studime e projekte kërkimore shkencore në të cilin angazhojnë edhe student dhe personel ndihmës akademik. Mjediset e UniBa janë të përshtatshme për kryerjen e angazhimeve mësimore dhe kërkimore shkencore të personelit në mënyrë profesionale, bazuar në profilin e programit të studimit, natyrës dhe veçorive të lëndëve dhe moduleve që mbulon secili punonjës.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik për programin MP MSHS</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>2</td> <td></td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>3</td> <td></td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>-</td> <td></td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>6</b></td> <td><b>0</b></td> <td><b>5</b></td> <td><b>1</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën]</i></p>	Kualifikimi i stafit akademik për programin MP MSHS	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1		1	-	Prof. Asoc.	2		2	-	Dr./PhD.	3		2	1	MSc.	-		-	-	<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>1</b>
Kualifikimi i stafit akademik për programin MP MSHS	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	1		1	-																															
Prof. Asoc.	2		2	-																															
Dr./PhD.	3		2	1																															
MSc.	-		-	-																															
<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>1</b>																															

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi bazuar në Neni.n 59, pikat 3, 4, 5, 6 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, për zhvillimin e programit të studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) janë 5 pedagogë me kohë të plotë dhe 1 pedagog me kohë të pjesshme, specifikisht: 2 janë personel akademik me titullin Prof.As. Dr, 2 me DR, 1 PhD janë personel akademik efektiv dhe 1 personel akademik me kohë të pjesshme me titullin Dr. Angazhimi i stafit akademik në këtë program studimi është bërë në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe është rregulluar me akte të brendshme të insitucionit. Ngarkesa mësimore e stafit akademik është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe është shpërndarë në mënyrë të tillë që të mbulojë plotësisht programin e studimit.</p> <p><i>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Evidenca 42. Ligji Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë 7.2. CV e Stafit Akademik., informacion nga vizita në institucion,] dhe aktet e brendshme rregullatore lidhur me punësimin e stafit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UniBa garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. Ai bazohet në Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Për rekrutimin e personelit, institucioni harton procedura e kritere specifike bazuar edhe në "manualin e menaxhimit të burimeve njerëzore", procedura të cilat administrohen nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa.</p> <p><i>(Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Evidenca 36. Të dhëna nga faqja zyrtare web e UniBa. Shpallja e</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><i>vendeve të lira)</i></p> <p>UniBa harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Njësia bazë evidenton nevojat çdo fillim viti akademik dhe këto kërkesa depozitohen pranë zyrës së burimeve njerëzore, e cila pas miratimit i publikon në faqen zyrtare, bazuar në kriteret e përgjithshme dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>UniBa ndjek gjithashtu një politikë vlerësimi të performancës që mat rezultatet e punës në raport me standardet dhe qëllimet e cila realizohet mbi krietet dhe procedurat e përcaktuara në dokumentacionin e brendshëm rregullativ. Stafi akademik është i punësuar sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe akteve rregullatore të brendshme të institucionit.</p> <p><i>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore].</i>  <i>[Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës].</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UniBa siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe ushtrimore si edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore në programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” (MPMSHS)</p> <p>Pjesë përbërëse e programit të studimit dhe specifikes së tij është edhe angazhimi i personeli ndihmës akademik, të cilët zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin përkatës të punës. Personeli ndihmës akademik dhe administrative është në shërbim të studentëve dhe në përmbushjen e objektivave të programit të studimit në Mësues në Shkenca Sociale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të</p>	<p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit mbledhen, ruhen dhe përditësohen rregullisht dhe janë të detajuara përsa i përket përfshirjes së anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në program, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> <p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është struktura</p>



<p>personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ parashikuar në rregulloren e saj. <b>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore].</b> Këto të dhëna përfshijnë CV e personelit, kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomatat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, dëshmi të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor etj. <b>[Evidenca 7.4. Formati i dosjes personale të stafit]</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale. Institucioni e ka të rregulluar me akte të brendshme zhvillimin e praktikave profesionale dhe ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit, me institucione në të cilat studentët mund të kryesjnë praktikat profesionale. Mbikëqyrja bëhet nga anëtarët e stafit akademik të cilët ndjekin zhvillimin korrekt të praktikës dhe japin vlerësimin përkatës. <b>[Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës]</b> Për zhvillimin e saj më mënyrë efektive UniBa ngarkon kryesisht personel akademik me kohë të plotë si përgjegjës të mbarvajtjes së këtij procesi. Të gjithë studentët pajisen me elementët e rregullores së praktikës profesionale që është një udhërrëfyes për zhvillimin e praktikës dhe vlerësimit e saj. UniBa ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, me karakter mësimor, për realizimin e praktikave mësimore. Plani mësimor i programit të studimit <b>MPMSHS</b> si dhe Rregullorja e Programit të studimit përcakton qartë detyrimet përmbyllëse. <b>[Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës]</b> Bazuar në aktet rregullatore të brendshme institucionale dhe të programit të studimit, studentët e ciklit të dytë të studimeve <b>MPMSHS</b>, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar i cili mbikëqyret dhe realizohet nga anëtarët e stafit akademik, që kanë detyrë të përgatisin një fond pyetjesh dhe pas miratimit nga njësi bazë, ja përcjell studentëve për tu përgatitur. Procesi zhvillohet sipas programit të miratuar. <b>[Evidenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMSHS]</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës</p>	<p>Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në</p>



<p>në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>realizimin e praktikave profesionale (drejtuese, mësuese të arsimit parauniversitar, ekspertë, etj) në bazë të marrëveshjeve të realizuara, i cili ndihmon studentët në përbushjen e detyrimeve, në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës si edhe është pjesë e procesit të vlerësimit të studentëve për praktikën profesionale përmes një protokollit të konsoliduar në këtë drejtim.</p> <p>Pedagogu i praktikës viziton institucionin pritës katër herë gjatë periudhës së praktikës, por nqs është e nevojshme dhe kërkohet nga studenti, realizohen takime të tjera përveç atyre të planifikuara.</p> <p>Në fund të praktikës studenti dorëzon raportin e praktikës sipas formatit dhe vlerësimi realizohet sipas evidencës 2.3, dhe përfshin raportin e praktikës të hartuar nga studenti, vlerësimin e mbikëqyrësit të institucionit pritës dhe vlerësimin e pedagogut përgjegjës.</p> <p>[Evidenca 2.3. UniBa Paketa e praktikës]  [Evidenca 27. Raporti i mbledhjes së departamentit, dt. 21.09.2022, caktimi i udhëheqësve të praktikës]  [Evidenca 27.1. Komunikime me stafin për zhvillimin e mbledhjeve të departamentit]</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi Master profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” (MPMSHS), i përbush plotësisht kriteret.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në</p>	<p>Institucioni ushtron aktivitetin e tij në 2 (dy) godina universitare dhe zotëron kushtet optimale në infrastrukturë dhe logjistikë për zhvillimin e mësimdhënies, trajnimeve dhe çdo nevojë tjetër.  Korpusi është ndërtuar me materiale cilësore bashkëkohore të</p>



<p>varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrative dhe standartet teknike, si dhe të gjitha ambientet ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien komode për studentët. UniBa i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollin e godinës së korpusit janë të instaluara bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse. Institucioni siguron në salla dhe zyra sisteme ajri të kondicionuar, përmes sistemin të ngrohjes së centralizuar. Godina garanton kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik.</p> <p><i>[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i>  <i>[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit UniBa në mjediset mësimore si klasa, laboratorë, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik dhe mësues akademik janë vendosur pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin WiFi, në ndihmë të përgatitjes, dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Të gjithë auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital. I gjithë kampusi është i pasur me të gjitha pajisjet e nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i>  <i>[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e</p>	<p>Për plotësimin e kërkesave të lëndëve mësimore, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit janë në disponon jo vetëm mjediset didaktike dhe laboratorike sipas llojit dhe profilit të degës por edhe të njësive të tjera ku zhvillohen aktivitete nga personeli i angazhuar në këtë program studimi. Zhvillimi i programeve lëndore nga personeli akademik janë konform të gjitha standardeve të kërkuara. UniBa gjithashtu ka ndërtuar faqen <u>Barleti Online</u> ku pasqyron të gjithë agjendën e</p>

<p>praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>trajnimeve dhe aktivitetet të karakterit akademik të zhvilluara.</p> <p><i>[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i>  <i>[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria]</i>  <i>[Evidenca 39 a. Manual i mësimdhënies online]</i>  <i>[Evidenca 36. Të dhëna nga faqja zyrtare web - Barleti online]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit UniBa siguron 3 laboratorë të karakterit pedagogjik që janë në funksion dhe mbështetje të studentëve, të cilët janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit dhe kanë akses të plotë në rrjet dhe WiFi Internet. Ato kanë në dispozicion edhe videoprojektor në kuadër të ilustrimit dhe shpjegimit për pedagogun dhe studentin, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i>  <i>[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale për të cilat UniBa vendos në dispozicion një listë me shkolla publike dhe private si edhe zyra arsimore në të cilat studentët mund të kryesjnë praktikat profesionale. Programi i studimit në strukturën e tij ka në vitin e dytë praktikë profesionale, e cila për nga specifika zhvillohet në mjediset shkollore të arsimit parauniversitar apo institucione arsimore. Bazuar në marrëveshjet e nënshkruara, praktikat mësimore të studentëve kryhen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, pra jashtë mjediseve të UniBa. Për realizimin e saj janë në dispozicion marrëveshjet institucionale dhe korespondencën e vazhdueshme institucionale.</p> <p><i>[Evidenca 2.3. UniBa Paketa e praktikës]</i>  <i>[Evidenca 27. Raporti i mbledhjes së departamentit, dt. 21.09.2022, caktimi i udhëheqësve të praktikës]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion janë të përshtatshme për realizimin e procesit</i></p>



	<i>mësimdhënës të programit të studimit "Master profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) dhe për formimin praktik të studentëve në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve. Literatura bazë dhe ndihmëse e lëndëve që i përkasin fushës së edukimit ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe ose cikle leksionesh të përgatitura nga lektorët mbi bazën e eksperiencave të universiteteve partnere brenda dhe jashtë vendit. Syllabuset të zhvilluara në këtë program studimi, azhurnohen çdo fillim viti akademik duke përcaktuar literaturën më të përditësuar. Literatura bazë dhe ndihmëse miratohet nga Njësia Bazë me propozimin e titullarit/pedagogut të lëndës Kjo literaturë e cila ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe pasqyrohet në programet lëndore dhe u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose elektronike, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi. Gjithashtu dhe fondi i literaturës fizike dhe online gjendet në bibliotekë.</p> <p><i>[Evidenca 30.b. Kërkesë për tituj librash DSHETP]</i>  <i>[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)]</i>  <i>[Evidenca 30. Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia bazë, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Propozimet e Njesisë Bazë miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. Edhe Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik. Përveç pasurimit periodik, literatura e bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të shtëpisë botuese Dudaj



	<p>dhe partnerëve të tjerë.</p> <p><i>[Evidenca 30.b. Kërkesë për tituj librash DSHETP]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka është e plotë nga pikëpamja e numrit të librave që vë në dispozicion dhe disponon 1 sallë leximi, të pajisur me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka ka një fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, në të cilat gjendet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit. Biblioteka shërben edhe si sallë internet. gjitha mjetet e nevojshme ku janë ofruar mundësi për lexime të qeta apo leximi dhe punë në grupë. Sistemi i menaxhimit dhe kontrollimit të librit nëpërmjet platformës digjitale mundëson depozitim total të titujve që disponojë dhe kategorizimin e librave sipas fushave përkatëse. Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në ambjentët e bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale digjitale të përdoruesit, përmes të cilës siguron literaturën. UniBa ka vënë në dispozicion edhe përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të shfrytëzojnë edhe materiale ndërkombëtare.</p> <p><i>[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i>  <i>[Evidenca 30.d. Të dhëna për infrastrukturën e Bibliotekës në funksion të programeve të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka Shkencore i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet</p> <p>Mjediseve si:</p> <p>Salla me fond të hapur. Salla është komode dhe është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 9:00 - 20:00. Në kompjuterat e saj janë instaluar programe specifike për disipinat e studimit, ku studentët studiojnë. Salla me fond të hapur ofron: literaturë referenciale, periodikun, literaturë print, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës; literaturë prej burimeve elektronike të huaja; akses në internet.</p> <p>Fondi i mbyllur. Fondi i mbyllur ofron: Literaturë në gjuhë të huaj, revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale.</p>



	<p>Fondi i bibliotekës pasurohet me tituj të rinj nga donatorë të huaj dhe vendas, shtëpia botuese partnere Dudaj apo autorë.</p> <p>Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare, pasi në të gjenden tituj nga fusha të ndryshme. UniBa ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombëtare.</p> <p><i>[Evidenca 30. Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtën e shfrytëzimit falas të mjediseve dhe fondit të bibliotekës. Studentët dhe stafi akademik që janë përdorues të bibliotekës pajisen me kartelën individuale. Biblioteka është e pajisur me fotokopje që ofrohet falas për fotokopje e printime në interes të studentëve.</p> <p><i>[Evidenca 30.a. Të dhëna të plota për platformat online të Bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Spektori i Informatikës mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, si dhe funksionimin të Hardware dhe Softwaret e të gjithë kompjuterave që disponon biblioteka.</p> <p>Në bibliotekë funksionon sistemi qendror i Arkives Dixhitale, i cili është i lidhur me serverin online të bibliotekës duke mundësuar arkivimin dhe ruajtjen në format elektronik të fondit të Bibliotekës, si edhe servirjen e këtij fondi nëpërmjet portalit web.</p> <p><i>[Evidenca 30.c. Platforma e bibliotekës online]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është e hapur çdo ditë në orarin 09.00 – 20.00 Këto orare bëjnë të mundur që biblioteka të aksesohet nga të gjithë studentët sipas mundësive dhe nevojave.</p> <p>Biblioteka ka një përgjegjës të angazhuar me menaxhimin dhe koordinimin e bibliotekës fizike dhe digjitale.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të</p>	<p>Institucioni e ka të rregulluar me akte të brendshme funksionimin e bibliotekës. Njësia përgjegjëse ka detyrë të ndjekë dhe raportojë</p>

<p>programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik duke hulumtuar mbi domosdoshmërinë që ka ekzistenca e literaturës përkatëse në bibliotekë.</p> <p><i>[Evidenca 30.b. Kërkesë për tituj librash DSHETP]</i>  <i>[Evidenca 30: Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit.]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi i studimit "Master profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme rekreative, etj).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre</p>	<p>UniBa disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve. Departamenti disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i</p>

<p>nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>studimeve. Të dhënat e studentëve dhe e gjithë ecuria e tyre gjatë ndjekjes së programit të studimit mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe hidhen në regjistrin themeltar dhe në regjistrin e programit mësimor përkatës. Sekretaria ruan të dhënat në versionin fizik dhe i hedh elektronikisht në system. Sekretaria mësimore administron regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>UniBa disponon të dhëna të detajuara, si përsa i përket ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë ose jo që është i angazhuar në mësimdhënie. Menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga sistemi i brendshëm i menaxhimit i cili administron dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, si dhe partnerëve të angazhuar për realizimin e programit. Ky sistem përbëhet nga</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Departamenti i Burimeve Njerëzore,</li> <li>-Sekretaria e Përgjithshme dhe Sekretaritë Mësimore,</li> <li>-Bordet e Karrierës Pranë Departamenteve,</li> <li>-Kordinatori Menaxhimit të Performancës</li> <li>-Zyra e Menaxhimit të Logjistikës dhe Operacioneve.</li> </ul> <p>Cdo dokumentacion ruhet dhe arkivohet me kujdes dhe sektori përkatës ka cdo evidencë si: ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, syllabuset etj. Departamenti i Burimeve Njerëzore mban dosjet e personelit me kohë të plotë, me të gjithë informacionin e duhur: CV, diploma universitare, diploma grada shkencore, dëshmi tituj akademikë, vërtetime punësimi, etj. Gjithashtu, mban edhe dosjet e personelit me kohë të pjesshme, me të gjithë informacionin e duhur: CV, diploma universitare, diploma grada shkencore, dëshmi tituj akademikë, vërtetime punësimi, kontrata, etj.</p> <p>Procesi i rekrutimit të stafit është gjithashtu i dokumentuar dhe ruhet në Departamentin e Burimeve Njerëzore</p> <p>Sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor.</p> <p>Këto njësi me anë të koordinimit në kuadër të funksioneve, përgjegjësi dhe ndërveprimit me njera tjetren, realizojnë të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë e domosdoshme të administrimit të institucionit.</p>

	<p><i>[Evidenca: "Shared" Intranet shared on '192.168.1.3']</i></p> <p><i>[Evidenca 7.1. Dosja-pedagog i brendshëm]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë akses në informacioni që lidhet me: kurrikulën e detajuar mësimore, listën e notate dhe kreditet, orarin mësimor, mungesat, faturat dhe pagesat e kryera, regjistrimi në provime. Stafi akademik hedh të dhëna dhe ka akses lidhur me procesin e vlerësimit të studentëve, plotësimin e listëprezencës së tyre dhe listën e studentëve që ndjekin kursin.</p> <p>Çdo personel akademik e ndihmësakademik (sekretaria mësimore) ka akses në llogarinë e tij ku shfaqen të dhëna rreth lëndëve, sezoneve të provimeve, oraret e tyre dhe listën e studentëve që janë regjistruar për të frekuentuar këto lëndë. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që mund të frekuentojnë, vlerësimet e çdo forme kontrolli në çdo lëndë etj. Secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, plani mësimor, struktura mësimore, oraret mësimore etj janë në faqen zyrtare web të universitetit.</p> <p><i>[Evidenca: "Shared" Intranet shared on '192.168.1.3']</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i komunikimit dhe format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes Web dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Google Classroom, Google Meet, Teams etj. Ky komunikim realizohet edhe në kontaktet individuale të personalizuara të pedagogut dhe studentëve, sekretarisë apo koordinatorëve të programeve me studentët.</p> <p><i>[Evidenca 29a. Manual i mësimdhënies online]</i></p> <p><i>[Evidenca 29. Guidë instruktive e mësimi On-line]</i></p> <p><i>[Evidenca 37. Manuali i përdorimit të portalit Studentor për administrim]</i></p> <p><i>[Evidenca 38.b. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët]</i></p> <p><i>[Evidenca 38.g. UniBa-google-classroom-manual-pedagogu]</i></p>





<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>UniBa bën analizën vjetore të veprimtarisë së aktivitetit akademik e administrativ të institucionit. Njësia bazë monitoron dhe raporton veprimtarinë shkencore të stafit akademik si edhe realizon raportime të rregullta mujore lidhur me veprimtarinë e tij drejt titullarit direkt, burimeve njerëzore dhe zyrës së performancës.</p> <p>Platformat elektronike gjithashtu garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqet zyrtare të internetit të institucionit janë të përditësuara me të gjithë informacionin në kohë reale. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të UniBa dhe rrjetet sociale përkatëse si Facebook, Instagram, YoutUniBa, Twitter në gjuhën shqipe dhe angleze.</p> <p><a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a>; <a href="http://www.ieb.edu.al">www.ieb.edu.al</a>; <a href="http://www.bttc.edu.al">www.bttc.edu.al</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UniBA disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit "Master profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove</p>	<p>UniBa harton çdo vit një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e</p>



<p>të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>programeve të studimit i mbështetur në raportet financiare të nevojave dhe të të ardhurave që vijnë nga njësitë bazë mbi programet e studimit që ato mbulojnë. Njësia Bazë ka për detyrë të paraqesë në dekanat kërkesën për përmbushjen e nevojave financiare të njësisë bazë lidhur me programet e studimit. Projekt buxheti vjetor hartohet mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UniBa</p> <p><i>[Evidenca 40. Të dhëna, Plani i financimit të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p><i>[Evidenca 40.a. Burimet Financiare UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, për çdo vit. Auditimi vlerëson efikasitetin financiar dhe mbarëvajtjen afatgjatë institucionale, për një administrim të kujdesshëm në zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke i paraprirë në këtë formë cdo problematike.</p> <p><i>[Evidencë 39. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor]</i></p>

	<i>institucional]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni ka krijuar zinxhirin hierarkik të raportimit, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike. Kjo formë raportimi evidenton nevojat, si dhe jep konkluzione mbi rezultatet e financimit të programit të studimit. Ndihmon në vendosjen e pritshmërive dhe planifikimet në vijim.  <i>[Evidencë 39. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Insitucioni ka ngritur strukturat e duhura dhe zotëron të ardhurat e nevojshme që garantojnë qëndrueshmërinë financiare. Zbaton procedura dhe ndjek procese vendimmarrje dhe bën auditim të rregullt lidhur me situatën e qëndrueshmërisë financiare të programeve të studimit. Burimet e financimit janë tarifat e studentëve, të ardhura nga projekte, të ardhura nga donacione, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni. Më qëllim mirë menaxhimit e këtyre fondeve dhe sigurimin e një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit.  <i>[Evidencë 39. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UniBa garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit. “Master profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) dhe mbështetjen e studentëve. Rekomandojmë që numri minimal i studentëve për çdo vit akademik, të jetë në përputhje me normativat në fuqi, për të siguruar në këtë formë sigurinë financiare të nevojshme dhe vijueshmërinë e sigurtë të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës IV	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti Barleti prezantohet me vizionin strategjik, pararojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, i aftë të udhëheqë studentët në tregun e punës, si dhe i aftë të përballojë sfidat e bashkësisë shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019, statutin e institucionit, rregulloren akademike UniBA, rregulloren e programit të studimit. Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, kuotave dhe kriterëve të propozuara nga Njësia bazë si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) është 2 (dy) vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) Programi i referohet nivelit 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të grumbullojë 120 kredite. Studentët në programet e ciklit të dytë të studimeve diplomohen me provim përfundimtar. Në përfundim të programeve të ciklit të dytë lëshohet diploma: Diplomë universitare Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Shkenca Sociale.</p> <p><i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Barleti", Kreu VI];</i>  <i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit "Barleti", Kreu IX]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>[Evidenca 3 . Rregullore e Programit MPMSHS]</i></p> <p>Barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje, për të gjithë kandidatët, garantohen nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe akteve të brendshme rregullatore të insitucionit. Procesi dhe procedurat e ndjekura në përcaktimin e kriterëve të pranimit në të gjitha ciklet janë të përcaktuara në Statutin e UGJ dhe në rregulloret e programeve të studimit. Statuti i Universiteti Barleti përshkruan qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëhiqen nga parimi i barazisë. Rregullorja e Universitetit, rregullore e programit, manualin e bursave e të gjithë aktet e tjera rregullatore të UniBa-s. Përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikat e transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale” (MPMSHS).</p> <p><i>[Evidenca 1.1.Statuti i Universitetit “Barleti”, Kreu VI];</i>  <i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit “Barleti”, Kreu IX]</i>  <i>[Evidenca 3 . Rregullore e Programit MPMSHS]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve, duke ndjekur procedurat standard dhe duke zbatuar të gjitha shkallët hierarkike të vendimmarrjes. Kriteret përcaktohen duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi Institucioni dokumenton të gjitha hapat dhe vendimet e marra lidhur me kriteret e pranimit të studentëve dhe ato janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike.</p> <p><i>[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2022-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme lehtësisht dhe janë transparente për publikun. Pranimi studentëve realizohet sipas sistemit meritë-preferencë ku kriteret e studimit të ofruara nga</p>



<p>të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>UniBa u bëhen të ditura paraprakisht kandidatëve për studentë në faqen zyrtare.</p> <p>Universiteti vë në dispozicion të aplikantëve zyrat e veta të informacionit dhe është shumë aktiv me njoftime në web dhe media sociale. Në faqen zyrtare publikohen edhe kriteret e pranimi, të përcaktuara për program të dytë studimi.</p> <p><i>[Evidenca 20.6. - Kriteret e pranimi të studentëve në 2022-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon studentët dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin U-Albania. UniBa përditëson sipas udhëzimeve dhe V.K.M-ve përkatëse portalin U-Albania në sesionin “Kriteret e Pranimi” i cili është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Universiteti nëpërmjet zyrës së Alumni, sekretarisë dhe njësisë bazë, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programit Master nëpërmjet disa formave Kriteret e pranimi të studentëve në çdo program studimi propozohen nga departamenti dhe miratohen me vendim Senati.</p> <p><i>[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimi të studentëve në 2020-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në programin e studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) nuk ka studentë me aftësi të veçanta apo nga shtresat e marginalizuara dhe pakicat.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në përgjithësi, institucioni parashikon aplikim nga kandidatë nga shtete të tjera, kriteri është njohja e diplomës paraardhëse në MAS.</p> <p>Për programin e studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Shkenca Social, UniBa parashikon kuotat të veçanta për regjistrimin e shqiptarëve nga trojet dhe nuk parashikon kriteret shtesë, përpos atyre që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>






	<i>[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2022-2023 dhe 2023-2024]</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Institucioni ka objektiv strategjik edhe aplikimin e parimeve të barazisë, të gjithëpërfshirjes dhe diversitetit si edhe trajtimin e studentëve me bursa financiare të plota ose të pjesëshme duke pasur parasysh studentët nga grupet vulnerabël dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet e brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>Në planin strategjik parashikohet që universiteti do të gjejë burimet financiare për vendosjen e bursave dhe stimujve të tjerë për studentët më të mirë. Miratimi përfundimtar i bursave bëhet nga Bordi i Administrimit dhe organizohet me qëllim vlerësimin e aplikimeve nga komisione ad hoc.</p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullorja e Universitetit Barleti, Neni 84]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se politikat e hartuara dhe procedurat e ndjekura dhe të zbatuara nga institucioni për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit janë në përmbushje të plotë të kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve të cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Institucioni publikon në web-in zyrtar informacionin lidhur me: Programet e studimit që ofron në të dyja ciklet e studimit; Kriteret e pranimit;</p> <p>Lëndët, modulet dhe kreditet që përmban çdo program studimi, midis tyre edhe Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Shkenca Sociale</p> <p>Kalendari akademik për të dyja ciklet e studimit;</p>

	<p>Përmes një bookleti të përgatitur jepet informacion orientues për studimet në UniBa. Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit të studimit]</i>  <i>[Evidenca 18. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UniBa pranon transferime të studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, gjithashtu lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë. Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme përmes:</p> <p>Rregullore e UniBa;  Rregullore e Njësisë Kryesore;  Rregullore e njësisë bazë  Rregullore e programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS)  Rregulloren e Transferimeve,  Manuali Rekrutim-Aplikim-Rregjistrim- Transferim, kreu VII</p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit]</i>  <i>[Evidenca 18. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim]</i>  <i>[Evidenca 19. Rregullore për Transferimin dhe Regjistrimin në Programe të Dyta]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit, kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dokumentimi i vlerësimeve dhe pragu i kalimit të vitit akademik janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të insitucionit:</p> <p>Rregullore e UniBa;  Rregullore e Njësisë Kryesore;  Rregullore e Njësisë bazë  Rregullore e programit të studimit “Master profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale”  Syllabuset e lëndëve</p>




	<i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit te studimit].</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kriteret e procedurat e diplomimit në programin e studimit Master Profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, si edhe në:</p> <p>Rregullore e UniBa Rregullore e Njesisë Kryesore Rregullore e Njesisë bazë Paketa e Provës Finale Paketa e provës finale cilëson të gjithë procedurat e provës finale dhe të temës së diplomës. Prova finale zhvillohet në trajtën e provimit të formimit dhe me punim diplome. Studentët me mesatare mbi 9.5 mund të përgatisin punim diplome.</p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit te studimit]</i> <i>[Evidenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMSHS]</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Çdo fillim viti akademik si edhe në mënyrë periodike gjatë vitit institucioni organizon një plan të detajuar rekrutimi e mbështetur nga një plan vjetor aktiviteteve, që synon të orientojë student potencial drejt programeve të studimit apo t’iu vijë në ndihmë studentëve të viteve të para që të njihen dhe takohen me studentët e tjerë të rinj, të familjarizohen me ambientet dhe infrastrukturën e Universitetit dhe të përgatiten për kryerjen e studimeve. Plani vjetor i aktiviteteve, përfshin konferenca me maturanët, konferenca me mësuesit e karrierës nëpër gjimnaze, vizita të stafit të UniBa në shkollat e mesme, konkurset, etj.</p> <p>Në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javën e Orientimit, ku studentët marrin informacione të rëndësishme në lidhje me Universitetin, shërbimet mbështetëse, këshilla për programin e studimit dhe kursin, zhvillimin e aftësive akademike, shkëmbimet studentore përmes programeve Erasmus +, aktiviteteve, klubet dhe përfitimet e jetës studentore Studentët prezantohen me mjediset universitare (auditorë, sekretari, Biblioteka, shërbimet e IT-së etj.). Gjithashtu ata njihen me profesorët dhe kurset që studentët do të marrin gjatë vitit të parë, si dhe planprogramin e secilës lëndë. Studentëve u jepen informacione për sezonet e provimeve, metodat e vlerësimit, të drejtat dhe detyrimet e tyre.</p> <p><i>[Evidenca 49. Axhenda Java e orientimit të studentëve e vitit akademik 2023-2024]</i></p>

	<i>[Evidenca 41. Strategjia e marketingut dhe rekrutimit]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar akte rregullatore dhe zhvillon praktika të mira lidhur me vënien në dispozicion të studentëve të informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit Master profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale”</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përmes Guidës së Studentit, studentët informohen rreth: strukturës organizative dhe autoritet vendimmarrëse në universitet, fakultet dhe departament dhe përgjegjësitë e seicilit; strukturat në ndihmë të studentit; programet e studimit që ofron fakulteti/departamenti, kohëzgjatjen, organizimin e kursit të studimit, kreditet, kërkesat e përmbushjes së detyrimeve, sylabuset e lëndëve, orarin mësimor, etj; Institucioni ka hartuar një Udhëzues informacioni si; (fletëpalosje, postera, broshura etj., si dhe materiale audio-vizive, si: spote televizive, mesazhe promociionale, etj) që i vlejnjë studentëve edhe për t’u përgatitur për këshillimin e personalizuar në vazhdim dhe jo vetëm për integrimin e tij në UniBa. Gjatë vitit akademik koordinatori i departamentit jep orientime të nevojshme dhe të vazhdueshme për organizimin e programit të studimit studentore por gjithashtu studentët kanë shumë aktivitete ku ndërthuren projektet e iniciuara nga pedagogët, departamentet si dhe nga vetë studentët nëpërmjet klubeve studentore.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të	Guida e Studentit, Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional Mësuesi në Shkenca Sociale, Rregullorja e UniBa, Plani mësimor i programit të studimit dhe Syllabuset e Master Profesional “Mësuesi në Shkenca Sociale” janë dokumenta të



<p>posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>prodhuara nga institucioni që vihen në dispozicion të studentëve me qëllim informimin për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Përmes web-it zyrtar të UniBa, studentët njihen me sezonet e provimeve, riprovimeve apo të mbartura. Komunikimi i brendshëm midis studentëve, pedagogëve dhe sekretarisë mësimore është i vazhduar dhe dinamik.</p> <p><i>[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)]</i>  <i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës ka si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar UniBa. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së kontakteve me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme publike dhe private, të cilat veprojnë në tregun e punës. Udhëzuesi përgatitur nga kjo zyrë, u vjen në ndihmë studentëve dhe ish-studentëve në procesin e kërkimit dhe aplikimit për vende pune. UniBa ka marrëdhënie me 15 shkolla 9-vjeçare dhe 7 gjimnaze në Tiranë, gjithashtu edhe me Bashkinë Tiranë, që janë një tregues tjetër. UniBa bashkëpunon në projekte të ndryshme në fushën e edukimit, të miratuara nga MAS në Elbasan, Durrës, Shkodër, Peshkopi, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Kavajë, Roskovec, etj. Informacioni dhe ushtrimet në të u vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Alumnit dhe Karrierës. e cila në bashkëpunim me njësitë e tjera zhvillojnë <u>aktivitete</u> dhe <u>trajnime</u> për të afruar studentët me <u>tregun e punës</u>. Në UniBa janë ngritur dhe funksionojné Bordet e Karrierës, në të cilat janë pjesë ekspertë dhe profesionistë të fushës dhe kanë për qëllim mbështetjen e studentëve në këtë proces.</p> <p><i>[Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]</i>  <i>[Evidenca 28. Vendim për krijimin e Bordit të Karrierës, DSHETP]</i>  <i>[Evidenca 22.2. Raportim vjetor Alumni ]</i>  <i>[Evidenca 22.1. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për</p>	<p>Java e Orientimit synon t'iu vijë në ndihmë studentëve të viteve të para që të njihen dhe takohen me studentët e tjerë të rinj, të familjarizohen me ambientet dhe infrastrukturën e Universitetit</p>

<p>zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>dhe të përgatiten për kryerjen e studimeve. Gjatë kësaj jave, Koordinator i Departamentit, Dekani i Studentëve dhe Sekretaria Mësimore mbajnë kontakte të rregullta me studentët dhe ato marrin informacione të rëndësishme në lidhje me Universitetin, shërbimet mbështetëse, këshilla për programin e studimit dhe kursin, zhvillimin e aftësive akademike, shkëmbimet studentore përmes programeve Erasmus +, aktivitetet, klubet dhe përfitimet e jetës studentore. Java e Orientimit, konsiston në prezantimin e studentëve me ambientet universitare (auditorë, sekretari, Biblioteka, shërbimet e IT-së etj.). Gjithashtu ata njihen me profesorët dhe kurset që studentët do të marrin gjatë vitit të parë, si dhe planprogramin e secilës lëndë. Studentëve u jepen informacione për sezonet e provimeve, metodat e vlerësimit, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Zyra Alumnit dhe Karrierës, është shumë active në cdo aktivitet ku studentët mund të këshillohen në lidhje me karrierën e tyre dhe të informohen për aktivitete të ndryshme studentore.</p> <p><i>[Evidenca 29.a Manual i mësimdhënies online]</i>  <i>[Evidenca 29. Guidë instruktive e mësimi On-line]</i>  <i>[Evidenca 36.a.Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit, Aneks 4].</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni për kurrikulat, aktivitetet dhe kalendarin akademik publikohen edhe në web-in zyrtar të UniBa dhe janë publikisht të aksesueshme.</p> <p>Në platformën Google Classroom publikohet në fillim të çdo semestri programet lëndore, temat e lëndës, literatura, vlerësimi i dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Studentët gjithashtu zotërojnë adresa personale të postës elektronike me domain @umb.edu.al</p> <p>Informacioni i detajuar, sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikua në faqen web.</p> <p><i>[Evidenca 29.a Manual i mësimdhënies online].</i>  <i>[Evidenca 29. Guidë instruktive e mësimi On-line]</i>  <i>[Evidenca 2.1.b. Plani mësimor Master Profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale].</i>  <i>[Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së</i></p>

	<i>Teknologjisë së Informacionit</i> <i>[Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies].</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UmiBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar akte rregullatore, ka ngritur strukturat përkatëse dhe zbaton praktika të mira për të vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit në Masterin profesional në "Mësuesi në Shkenca Sociale".			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### **Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Universiteti Barleti disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Profesional në " Mësuesi në Shkenca Sociale " përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së "Alumnit dhe Karrierës". Ato, mbledhin, përpunojnë, ruajnë dhe paraqesin informacione statistikore. Nuk ka ende studentë të diplomuar në këtë program, por studentët aktual janë të gjithë të punësuar.  <i>[Evidenca 26.2 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje].</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo	Universiteti disponon dokumentacion të plotë periodik në lidhje me statistikën vjetore të studentëve të regjistruar, klasifikimin e studentëve të rinj në programet e studimeve sipas gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimeve, të diplomuar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit. Për këtë program studimi nuk ka studentë të diplomuar.

mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Viti akademik 2022-2024	Studentë të regjistruar	Nota mesatare në hyrje
	Studentë në vit të I	3	7
	Studentë në vit të II	5	6.8

*[Evidenca 26.2 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje].*

**Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht nëpërmjet Sekretarisë Mësimore. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale nga UniBa bazohen në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna statistikore janë lehtësisht të aksesueshme nga personat e autorizuar (student, pedagogë, drejtues institucioni, etj). Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të dokumentacionit pranë Njësive bazë, Njësive kryesore dhe Sekretarive mësimore, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

*[Evidenca 38.i. Manuali i përdorimit të portalit Studentor për administrimin]*  
*[Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit]*

**Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet

Institucioni ka hartuar akte lidhur me kontrollin periodik për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), si dhe vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. Portali studentor, është platforma ku gjenden të hedhura të dhënat mbi notat dhe lëndët e dhëna provim për cdo student.

*[Evidenca 38.i. Manuali i përdorimit të portalit Studentor për*



me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>administrimin]</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>UniBa bazuar në raportet vjetore të Njësive bazë dhe raportet vjetore të Fakulteteve, Sekretarinë mësimore, zyrës së Alumni dhe Karriera dhe Vlerësimit të Vazhduar, harton Raportin vjetor Institucional ku përfshihen veprimtaria mësimore dhe shkencore, ecuria e programeve të studimit, si dhe informacione për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><i>[Evidenca 35. a. Plani Vjetor i punës së Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca 35. Analiza Vjetore së Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca 22.1. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentët e MPMSHS]</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Sistemi i follow up duhet të funksionon edhe në vazhdimësi.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve	<p>Institucioni ka të rregulluar me akte përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Institucioni është angazhuar në përfshirjen e studentëve në vendimmarrje përmes pjesëmarrjes së tyre në Senatin Akademik.</p>

<p>ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Gjithashtu, pjesëmarrja e studentëve në grupet e vlerësimit të cilësisë është një tregues i përfshirjes dhe kontributit të tyre në sigurimin e cilësisë së punës së institucionit. Një nga strukturat e ngritura në institucion është edhe Këshilli Studentor. Studentët janë të përfaqësuar gjithashtu edhe në: Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta; Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë; Dekanatin e Fakultetit; si edhe Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët, etj.</p> <p><i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti].</i>  <i>[Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore]</i>  <i>[Evidenca 20.1. Rregullore e Organizimit të Zgjedhjeve për Qeverinë Studentore]</i>  <i>[Evidenca 20.2. Strategjia e Klubeve Studentore]</i>  <i>[Evidenca 20.3. Manual Klubet Studentore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni përmes akteve dhe veprimtarive konkrete garanton përfshirje reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme, të studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Sondazhi që bëhet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dy herë në vit mbledh të dhëna për secilën lëndë dhe secilin pedagog</p> <p>Institucioni raporton mbi aktivitetet vullnetare të studentëve të UniBa dhe publikon Kalendarin e Aktivitetet Studentore. Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentorë, institucionale dhe njësi kryesore. Studentët janë anëtarë të GVB për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i>  <i>[Evidenca 45a. Guida për fokus grupin].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në</p>	<p>Përmes anketës që Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, kryen dy javë përpara mbarimit të çdo semestri, me secilin grup, në të gjitha programet e studimit, siguron që studentët të përfshihen në vlerësimin e cilësisë së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>veprimtarisë akademike dhe shkencore të stafit akademik;</li> <li>të infrastrukturës akademike dhe shkencore;</li> <li>të komunikimit dhe marrëdhënieve;</li> <li>aksesin në informacion për programet e studimit dhe aktivitetet</li> </ul>

mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	që zhvillohen në institucion dhe jashtë tij; metodat dhe mjetet e mësimdhënies; ndihmën dhe mbështetjen e pedagogëve dhe të strukturave të tjera.  <i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Përmes instrumenteve matëse dhe vlerësuese të programit të studimit dhe të stafit akademik, studentët japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.  <i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti, neni 88].</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar politika, akte rregullatore për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe ka ngritur sistemin dhe strukturat përkatëse për të zbatuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore	Zyra e Pranimi, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra “Alumni dhe Karriera” dhe Departamenti, përmes koordinorit të tij, informojmë dhe mbështesin studentët për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në Universiteti Barleti, si; shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentët e rinj, dhënien e informacioneve për programet,

të institucionit.	<p>kurrikulat e studimeve, diplomat, këshillimin e studentëve të UniBa që diplomohen në nivelin e dytë për mundësitë e studimeve në nivelet e tjera, këshillimin e studentëve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve, ofron për studentët trajnime, infor day, takime të hapura etj.</p> <p><i>[Evidenca 20. Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentëve].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i komunikimit të brendshëm Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor, mundësojnë ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ata mund t'i drejtohen Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së “Alumnit dhe Karrierës”, për të marrë informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda e jashtë UniBa</p> <p>Informimi i studentëve bëhet edhe nëpërmjet fazes zyrtare Web të Universitetit dhe njoftimeve në rrjetet sociale. Informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit të realizohet nëpërmjet njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca 20. Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentëve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Dekani i Studentëve dhe Zyra “Alumni dhe Karriera” kanë si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë UniBa. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së kontakteve me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme publike dhe private, të cilat veprojnë në tregun e punës. Udhëzuesi përgatitur nga kjo zyrë, u vjen në ndihmë studentëve dhe ish-studentëve në procesin e kërkimit dhe aplikimit për vende pune. Informacioni dhe ushtrimet në të u vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së “Alumni dhe Karriera”.</p> <p>Nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikëqyrur lëndën e praktikës profesionale, studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale. Një ndër strukturat studentore që</p>



	organizon studentët dhe zhvillon aktivitete lidhur me zhvillimin e karrierës është edhe <u>Klubi i Karrierës</u> .			
	<i>Evidenca 20.Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentëve</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra “Alumni dhe Karriera” duke përdorur formularë të dedikuar ka bërë gjurmimim e punësimit të studentëve që janë diplomuar në rang universiteti. Çdo vit, zyra “Alumni dhe Karriera” harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve Përfshirja e ish-studentëve të UniBa në jetën aktuale universitare realizohet nëpërmjet: Eventeve dhe aktiviteteve që organizon UniBa; Promovimit të alumni nëpërmjet programeve edukative, profesionale dhe sociale që ndodhin në UniBa; Përfshirjes së alumni në programet e ndryshme universitare; Sigurimi i kontakteve të vazhdueshme midis alumni dhe UniBa Grupi Barleti ka një rrjet të gjerë strukturash në kërkim shkencor dhe në angazhimin e studentëve me punëdhënësit e ardhshëm si BTTC dhe AM-Barleti Human Capital.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura dhe ka ngritur njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Investimi në cilësinë e mësimdhënies është një përparësi e Universitetit, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu objektiv i rëndësishëm është edhe favorizimi i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog.</p> <p>UniBa harton udhëzues, manuale si “Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë” dhe “Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë” si dhe kryen trajnime në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UniBa ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale edhe metoda didaktike innovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]</i></p> <p><i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i></p> <p><i>[Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies]</i></p> <p><i>[Evidenca 38.a. Manuali i mësimdhënies online]</i></p> <p><i>[Evidenca 38.a. Guidë instruktive e mesimit On-line]</i></p> <p><i>[Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies dhe e stafit akademik monitorohet, matet dhe vlerësohet rregullisht përmes mekanizmave të tillë si pyetori i vlerësimit të performancës së stafit akademik nga studentët dhe formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC), Zëvendës Rektori për Çështjet Akademike, Zyra e Vlerësimit të Performancës dhe njësitë bazë bashkërendojnë punën e tyre në</p>

<p>ndihmësakademik.</p>	<p>vazhdimësi për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e mësimdhënies</p> <p>UniBa është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë funksionon Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancë ka përgjegjësinë e zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UniBa, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimin të lartë.</p> <p><i>[Evidenca 16.5. Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching)]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 14. Format i raportimit të punës semestrale]</i></p> <p><i>[Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve përmes pyetësorëve anonimë që plotësohen 2 herë në vit. Ky proces zhvillohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancë .</p> <p><i>[Evidenca 40.4 Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullore e universitetit "Barleti"]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>UniBa i përmbahet Standardeve Evropiane kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NjZHKC mbështetur në Statutin e UniBa hartojnë dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me rekomandimet përkatëse. UniBa në përmjet faqes zyrtare web pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të gjithë të interesuarit në kuadër të</p>

	<p>sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancë harton raportin vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa.</p> <p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UniBa, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në bazë të Rregullores për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës, periudha e vlerësimit të performancës së stafit akademik janë muajt Mars dhe Shtator që përkrijnë me përfundimin e semestrit.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet përmes të dhënave dhe treguesve të ndryshëm cilësorë dhe sasiorë të cilët analizohen dhe rishikohen nga stukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë në shumë nivele.</p> <p>Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit bëhen të ditura përmes raportimeve të NjZHKC, njësive bazë dhe fakultetit.</p> <p><i>[Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p> <p><i>[Evidenca 13.b. Shkëmbime të stafit Erasmus +]</i></p> <p><i>[Evidenca 51. Promovim i shembuj të praktikave të mira]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar dhe ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Struktura përkatëse e sigurimit të cilësisë ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit dhe raporte monitorimi dhe vlerësimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i	Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UniBa mbështetet në akte të






<p>arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>brendshme rregullatore që përcaktojnë politikat, strategjitë, strukturat dhe procedurat e procesit, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Universiteti Barleti, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni. 103, Institucioni ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në Universiteti Barleti funksionon Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë si edhe, struktura këto përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UniBa, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në arsimin e Lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë.</p> <p>Në Statutin e UniBa <i>neni 10, neni 28, Rregulloren e UniBa neni 14, neni 15.</i> si dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në UniBa është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i cili ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik të UniBa-s <i>neni 15</i>, por dhe strukturë përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor.</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]</i></p> <p><i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i></p> <p><i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti]</i></p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullore e universitetit "Barleti"]</i></p> <p><i>[Evidenca 17.1. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p> <p><a href="https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html">https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji</p>	<p>Në UniBa është ngritur dhe funksionon sistemi i Sigurimit të Cilësisë, procesi i të cilit është detyrë dhe realizohet nga NjZhKC e cila bashkëpunon me Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Zyrën e Pranimeve, Dekanin e studentëve, njësitë bazë e kryesore. UniBa zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e</p>

<p>institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>vazhdueshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me aktorë të ndryshëm ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Në bazë të Statutit të UniBa, për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional, përfshihet një përfaqësues nga këshilli studentor i programit të studimit. Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maurantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. Në strategjinë UniBa 2020 - 2030 janë parashikuar objektivat lidhur me përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike si: Punësimi i të diplomuarve, përmirësimi i kurrikulave dhe pasurimi i bibliotekës, mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në UniBA, ndërkombëtarizimi etj.</p> <p><i>[Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030]</i>  <i>[Evidenca 20. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa]</i>  <i>[Evidenca 34. Marrëveshje Bashkëpunimi]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Në funksion të sigurimit të cilësisë Universiteti Barleti përdor instrumentat për sigurimin e cilësisë si, riakreditimi institucional dhe ri/akreditimi i programeve të studimit bazuar në metodat e përcaktuar nga ASCAL-i. UniBa i është nënshtruar një sërë procesesh riakreditimi institucional, i fundit është realizuar në vitin 2021, i cili ndiqte akreditimin e vitit 2017 nga Agjencia britanike, QAA, Bazuar në Statutin e Universitetit kryet procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, ku organizohen pyetësorë studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve. Program i studimit Master Profesional në Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) nuk është akredituar asnjëherë që nga hapja e tij.</p>




	<p><i>[Evidenca 16.5. Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching) ]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet:</p> <p>përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore,</p> <p>standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit sic përcaktohen në kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë;</p> <p>rregullores së studimeve për çdo program;</p> <p>politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore;</p> <p>infrastrukturës mësimore;</p> <p>ndërkombëtarizimit të programeve;</p> <p>monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë bëhet dhe raportohet mbështetur në standarde cilësie dhe indikatorë sasiorë të matshëm.</p> <p><i>[Evidenca 14. Format i raportimit të punës semestrale]</i></p> <p><i>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i></p> <p><i>[Evidenca 17.1. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p> <p><i>[Evidenca 52. Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se UniBa ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së punës në institucion. Gjithashtu janë hartuar dokumenta që mbështeten në politikën dhe strategjinë e insitucionit për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni parashikon procese për hartimin dhe miratimin e programeve që ofron. Programet hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushin objektivat dhe rezultatet e të nxënit. Diploma e dhënë për programin përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe europiane të kualifikimeve. Institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Veprimet e ndërmarra si rezultat i vlerësimit dhe përmirësimit i komunikohen palëve të interesuara.</p> <p>Përmes përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit si dhe standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit, e një sërë procedurash e mekanizmash formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale”, raportimeve për realizimin e programit, raportimeve për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit, ngritjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, etj.</p> <p>UniBa ka krijuar mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij.</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i>  <i>[Evidenca 35. Raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>







<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p> <p>Raportet e vlerësimit që hartohen nga NjZhKC përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>NjSKC harton raporte periodike lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku analizohen arritjet dhe mosarritjet, adresohen mangësitë dhe mënyrat e përmirësimit.</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në të gjitha aktet e brendshme rregullatore institucionale dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga njësi bazë, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstytucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, me qëllim vlerësimin e realizimit dhe të garantimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>UniBa aplikon metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë në programin e studimit Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) si: raportimi nga pedagogu për punën semestrale; vlerësim i studentëve në fund të çdo semestri nga NJZHKC; vëzhgime në auditor; rezultatet e provimeve, etj.</p> <p><i>[Evidenca 14. Format i raportimit të punës semestrale]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studenteve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 16.5. Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë]</i></p> <p><i>[Evidenca 2.5. Model Teza e provimit të lëndës]</i></p> <p><i>[Evidenca 14. Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie]</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Siç është përcaktuar qartë në të gjitha aktet e brendshme rregullatore institucionale dhe siç evidentohet nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, UniBa përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve Sondazhe të studentëve që diplomohen; Sondazhe të Qeverisë studentore dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program me qëllim në vlerësimin e realizimit dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS)”.</p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Raportet e arritjeve mbështeten mbi analiza SWOT.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të</p>	<p>UniBa parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>

<p>cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në statutin e Universitetit struktura përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor është Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në Arsimin e Lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë.</p> <p>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë mund të angazhojë periodikisht ekspertë të jashtëm për çështje specifike ose/dhe specialistë të niveli të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë sipas nevojës për konsulencë, ekspertizë ose për çështje të tjera. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga këshilli studentor. Në rast nevojë ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, nga zyra e Alumnit dhe Karrierës realizon kontakte të vazhdueshme me studentët alumni mbi ecurinë në tregun e punës dhe është pjesëmarrëse dhe promovuese e programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturanët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë</p>	<p>Universiteti "Barleti" përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>

<p>të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Komisionit të Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, kanë përgjegjësi dhe detyra të cilat specifikohen në Rregulloren e UniBa-s, Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, si dhe në planin e punës së njësisë. UniBa bazohet gjithashtu edhe tek indikatorët që përcillen nga njësiti. NjZhKC ka si indikatorë parësorë monitorimin semestral të respektimit të Kalendarit Akademik dhe vlerësimin e pedagogut. NjZhKC ka përgjegjësinë e menaxhimit në hartimin e programeve cilësore që plotësojnë nevojat e tregut të punës, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, akreditimin e programeve të studimit dhe institucionit.</p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i>  <i>[Evidenca 48. Plani i punës së Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i>  <i>[Evidenca 15. Manuali i cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Statuti i UniBa përcakton përfshirjen e strukturave hierarkike të brendshme në procesin e sigurimit të cilësisë, midis tyre edhe njësinë bazë. Statuti garanton mbështetjen e procesit të sigurimit të cilësisë në parimin e transparencës dhe të gjithëpërfshirjes. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. Në Statutin e Universitetit është parashikuar dhe ngritja në nivel fakulteti e komisioneve e garantimit të cilësisë së njësisë kryesore dhe programeve të studimit me përfaqësues të personelit akademik dhe atij ndihmës administrativ me karakter mësimor dhe përfaqësues të studentëve. Njësia bazë është përgjegjës për programet studimit që ofron, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtyre programeve në bashkëpunim me të gjitha nivelet e strukturave përbërëse, kjo bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që institucioni ka të parashikuar.</p> <p><i>[Evidenca 1.4.f. Dërgohet urdhri i Rektorit Nr. 44 për GVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të</p>	<p>E gjithë baza rregullatore e UniBa garanton përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të</p>



<p>brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>vlerësimit duke respektuar integritetin akademik, transparencën, shmangien e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, në përputhje me Kodin e Etikës Veprimtaria e UniBa me studentët dhe personelin mbështetet në meritat personale dhe përjashton çdo lloj diskriminimi” (Statuti UniBa-s, neni 3, pika 3).</p> <p><i>[Evidenca 33. Kodi i Etikës]</i> <i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Statuti UniBa, Rregullorja e Njesisë Bazë për Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë dhe praktika e punës në institucion, sigurojnë pjesëmarrje aktive në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, edhe të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Pjesëmarrja dhe promovimi i programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluara nga Njësia Bazë në bashkëpunim me zyrën e Alumni, dhe në bashkëpunim me studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës u shërben studentëve për një qasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi.</p> <p><i>[Evidenca 34. Marrëveshje Bashkëpunimi]</i> <i>[Evidenca 28. Vendimi për ngritjen e Bordit të Karrierës]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Universiteti "Barleti" nëpërmjet faqes zyrtare web dhe programit të trasparencës në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bën publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit mekanizmat kontrollues dhe monitories si; Planet e veprimtarive akademike kërkimore shkencore vjetore, Raporte monitorimi për cilësinë e pogrameve të studimit, Raporte të vlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional, Raporte të vlerësimit të jashtëm për akreditimin institucional, Raporte monitorimi të performancës në Universitet etj.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html">https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/neës4901.html">https://umb.edu.al/neës4901.html</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Universiteti "Barleti" në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit, respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Raporti vjetor i NjZhKC, publikohet duke respektuar lirinë akademike dhe ruan etikën akademike</p> <p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara si dhe përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik.</p> <p>Raportet e vlerësimit që hartohen nga NjZhKC-ja përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Njësia bazë harton raporte periodike lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku analizohen arritjet dhe mosarritjet, adresohen mangësitë dhe mënyrat e përmirësimit. Program i studimit Master Profesional Mësuesi në Shkenca Sociale (MPMSHS) i është nënshtruar procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, ku midis të tjerave janë evidentuar edhe</p>

	<p>pikat e forta dhe të dobëta të tij si dhe janë dhënë rekomandime për përmirësim. Ky program nuk i është nënshtruar procesit të akreditimit.</p> <p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NjZhKC-ja dhe njësia bazë vlerësojnë periodikisht rezultatet dhe kërkimore shkencore të UniBa, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre në të ardhmen. Edhe rekomandimet e lëna institucionit në kuadër të akreditimit institucional kanë shërbyer për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre në të ardhmen. Njësia bazë dhe kryesore, mbështetur në informacionet e mbledhura mund të kërkojë ndryshim pas një cikli të plotë të programit të studimit: në fund të dy viteve për programet <i>Master profesional</i> me 120 ECTS, pas akreditimit të tyre dhe si rregull vetëm njëherë nga një akreditim në tjetrin.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UniBa dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për t'i informuar në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore, plotësimin të pyetësorëve, pjesëmarrjes në Sondazhe Kombëtare të studentëve, publikimit të njoftimeve në rrjetet sociale të Universitetit, njoftimeve në email- et zyrtare etj.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/news4901.html">https://umb.edu.al/news4901.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/news5125.html">https://umb.edu.al/news5125.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/news5030.html">https://umb.edu.al/news5030.html</a></p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni reflekton transparence dhe efektivitet në politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duke i bërë ato publike me qëllim krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i></p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>		

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master profesional “Mësuesi në Shkenca Sociale” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti “Barleti”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit Master profesional “Mësuesi në Shkenca Sociale”, është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit dhe të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në Universitetin “Barleti”.
2. Universiteti “Barleti” ka infrastrukturë bashkëkohore në funksion të një mjedisi interaktiv të mësuarit dhe aftësimi profesional.
3. Universiteti “Barleti” ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimi profesional, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor.

**Pika të dobta**

1. Mungesa e mobilitetit të studentëve nga programi i studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Shkenca Sociale” drejt programeve të ngjashme në universitete jashtë vendit dhe anasjelltas. (standarti I.3. kriteri 3).
2. Mungesa e përputhshmërisë së planit mësimor të programit të studimit me VKM 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) në organizimin e tij, në peshën specifike të komponentëve të veprimtarive formuese dhe në lëndët e përcaktuara për komponentët D dhe C. (Standarti II.1., kriteri 1, kriteri 3, Standarti II.3, kriteri 4, Standarti II.4. Kriteri 3).
3. Mungesa e evidencave të përmbushjes së rekomandimit të lënë në urdhrin e hapjes së programit të studimit mbi rishikimin e titullit dhe për rrjedhojë përmbajtjes së lëndës “Metodat e avancuara të kërkimit”, e cila në planin mësimor të programit të studimit duhet



të ishte ndryshuar në "Metodat e kërkimit në edukim"(standarti II.1., kriteri 1, Standarti II.3, kriteri 5).


4. Mungesa e dosjes së plotë të programeve lëndore në përputhje me planin mësimor të programit të studimit dhe në zberthim të kompetencave dhe aftësive që duhet të përfitojë mësuesi i shkencave sociale (Standarti II.1., kriteri 2, Standarti II.4. Kriteri 1, kriteri 6).
5. Tejkalimi i peshës specifike prej 25% të krediteve të programit të studimit në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik (Standarti II.7, kriteri 4).
6. Mungesa e kriterëve që përcaktojnë profilin e diplomës së ciklit të parë për kandidatët aplikantë në programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Shkenca Sociale" (Standarti II.7, kriteri 5, kriteri 6).
7. Mungesa e një një studimi tregu pune të mirëfilltë për programin e studimit (Standarti II.7, kriteri 4).

### Rekomandime

- 1- Institucioni të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Shkenca Sociale", në mënyrë që të ketë tregues të studentëve përfitues nga programet e shkëmbimit.
- 2- Në përmbushje të përcaktimeve të VKM 41 (të ndryshuar) sugjerojmë që Departamenti Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional të rikonsiderojë peshën specifike të kategorive dhe komponentëve mësimorë, veçanërisht përkatësinë e lëndëve të komponentit mësimor të kategorisë D dhe C.
- 3- Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional të plotësojë rekomandimin e lënë nga ekspertët në Urdhrin e hapjes së programit të studimit Nr. 1760/2, datë 04.10.2022
- 4- Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional të krijojë dhe të mbajë një dosje të plotë të programeve lëndore të programit të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Shkenca Sociale", në të cilat të dëshmohet zberthimi i kompetencave të Mësuesit të Shkencave Sociale.
- 5- Sugjerohet rishikimi i peshës specifike të lëndëve të formimit psiko-pedagogjik për të mos tejkualuar peshën specifike prej 25% të krediteve, pasi çënohet cilësia kurrikulare dhe e formimit të specializuar në funksion të lëndëve karakterizuese në fushë të shkencave sociale.
- 6- Të përcaktohen në mënyrë eksplicite në kriteret e pranimit për programin e studimit profilet e diplomave të ciklit të parë për kandidatët aplikantë në programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Shkenca Sociale".
- 7- Hartimi i një studimi tregu pune të mirëfilltë për programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Shkenca Sociale".



97



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Teacher in Social Sciences" provided by the Institution of Higher Education, "Barleti" University**

**Strengths and Affirmations**

1. The professional Master's study program "Teacher in Social Sciences" falls into the academic field of the Faculty of Social Sciences, Tourism and Sports and the Department of Educational Sciences and Vocational Training at "Barleti" University.
2. "Barleti" University offers state-of-the-art facilities in view of interactive learning in a professional training environment.
3. "Barleti" University implements transparent and effective policies to increase partnership and cooperation with institutions, companies, third parties, domestic and/or foreign business actors in order to carry out the study program, within the framework of professional training and practices, and scientific research.

**Weaknesses**

1. The lack of student mobility from the "Professional Master" study program to "Teacher in Social Sciences" towards similar programs in universities abroad and vice versa. (standard I.3. criterion 3).
2. The lack of compatibility of the study program curriculum with VKM 41, dated 24.01.2018 (amended) in terms of organization, specific weight of the components of formative activities and subjects defined for components D and C. (Standard II.1., criterion 1, criterion 3, Standard II.3, criterion 4, Standard II.4. Criterion 3).
3. The lack of evidence that the requirements of the recommendation have been met for the implementation of the study program, hence reviewing the title and therefore the content of the course "Advanced research methods", which should have been replaced in the study program curriculum by "Research methods in education" (standard II.1., criterion 1, Standard II.3, criterion 5).
4. The lack of a thorough file of subject programs in accordance with the study program curriculum and with a detailed schedule of the skills that the social science teacher should acquire (Standard II.1., criterion 2, Standard II.4. Criterion 1, criterion 6).
5. Exceeding the specific weight of 25% of study program credits for general psycho-pedagogical training (Standard II.7, criterion 4).
6. The lack of criteria to outline the profile of the first cycle diploma for applicants to the "Professional Master" study program in "Teacher in Social Sciences" (Standard II.7, criterion 5, criterion 6).
7. The lack of an actual labor market study for the study program (Standard II.7, criterion 4).



## Recommendation

1- The institution should work more effectively towards promoting student mobility of the "Professional Master" in "Teacher in Social Sciences" study programs, in order to gather indicators of students benefiting from exchange programs.

2- To fulfill the provisions of VKM 41 (amended), we suggest that the Department of Vocational Education and Training Sciences reconsider the specific weight of categories and teaching components, with special regard to the relevance of the subjects of the teaching component of category D and C.

3- That the Department of Educational Sciences and Vocational Training complete the recommendation by the experts in the Order opening the study program No. 1760/2, dated 04.10.2022

4- That the Department of Educational Sciences and Vocational Training create and maintain a complete file of the subject programs of the "Professional Master" study program in "Teacher in Social Sciences", where the assessment of the skills of the Social Science Teacher is proven.

5- It is also suggested to revise the specific weight of the psycho-pedagogical training courses so as not to exceed the specific weight of 25% of the credits, since it would affect the curricular quality and specialized training related to the characteristic courses in the field of social sciences.

6- To explicitly define the profiles of the first-cycle diplomas for applicants to the "Professional Master" study program in "Teacher in Social Sciences" in the admission criteria for the study program.

7- To outline and design a genuine labor market study for the "Professional Master" study program in "Teacher in Social Sciences".

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>			X	
<b>MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X